


VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË SË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQEDONINË E VERIUT DHE NË RAJON PËRMES INDEKSIT TË HAPJES



METAMORPHOSIS 

 ActionSEE

Ky publikim është përgatitur nga Fondacioni Metamorfozis në kuadër të projektit të financuar nga Fondi Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy – NED) dhe Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument përfaqësojnë mendimet e autorëve dhe nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

**VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË SË
PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQE-
DONINË E VERIUT DHE NË RAJON
PËRMES INDEKSIT TË HAPJES**



VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË SË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQEDONINË E VERIUT DHE NË RAJON PËRMES INDEKSIT TË HAPJES

SIPAS MATJES SË VITIT 2022

Shkup, 2023

Tituli origjinali: **Процена на доброто владеење на извршната власт во северна Македонија и регионот преку Индексот на отвореност**

© 2023 **Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis**

Shkup, 2023

Botues: **Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis**,
rr. "Apostol Guslarot" nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Autore: **Dançe Danillovska Bajdevska** (Данче Даниловска Бајдевска),
Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis

Redaktor: **Bardhyl Jashari** (Бардил Јашари), Drejtor Ekzekutiv,
Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis

Përkthimi dhe lektura: **Bestel DOOEL** Shkup, (Maqedonia e Veriut)
(превод од македонски на албански јазик)

Dizajni: **Royal Art**, Shkup, (Maqedonia e Veriut)

Shtypshkronja: **Royal Art**, Shkup, (Maqedonia e Veriut)

Tirazhi: : 50

CIP – Каталогизација во публикација

PËRMBAJTJA

SHKURTESA.....	7
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	11
3. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	13
3.1. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON	13
3.1.1. Hyrje	13
3.1.2. Hapja e autoriteteve ekzekutive në rajon	14
3.1.3. Politika e hapjes nuk është prioritet i shteteve të rajonit.....	15
3.1.4. Partneriteti për Qeverisje të Hapur – një mundësi apo shans i humbur.....	17
3.1.5. Asnjë mbikëqyrje të informacionit konfidencial.....	18
3.1.6. Ende nuk dihen informacionet bazë për punën e autoriteteve.....	20
3.2 PËRMBLEDHJE PËR PUSHTETIN EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	21
3.3. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQEDONINË E VERIUT	28
3.3.1. Transparenca	33
3.3.2. Qasshmëria	38
3.3.3 Efikasiteti (planifikimi strategjik, raportimi, monitorimi dhe vlerësimi).....	43
3.3.4. Integriteti	45
3.3.5. Të dhënat e hapura	48
4. REKOMANDIME PËR PUSHTETIN EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	53

SHKURTESA

ACTION SEE - Llogaridhënie, Teknologji dhe Rrjeti i Institucioneve të Hapura në Evropën Juglindore

ENER – Regjistri i Vetëm Elektronik Kombëtar i Dispozitave

QLI – Qasja e lirë në informatat me karakter publik

BdheH – Bosnja dhe Hercegovina

OShC - Organizatë e shoqërisë civile

CV - Curriculum vitae/Biografi e shkurtër

BE - Bashkimi Evropian

FBdheH - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës

LQLIKP – Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik

GRECO - Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (The Group of States against Corruption – GRECO)

MNR – Mekanizmi Ndërkombëtar i Raportimit

NATO – Aleanca e Atlantikut të Veriut

PQH - Partneriteti për Qeveri të Hapur:

OECD – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

VNR - Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (Regulatory Impact Assessment – RIA)

TAIEX – Instrumenti i Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit i Komisionit Evropian

Me mbështetjen e Fondit Kombëtar për Demokraci dhe Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni, Fondacioni Metamorfozis në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal i OShC-ve - Llogaridhënie, Teknologji dhe Rrjet i Institucioneve të Hapura në Evropën Juglindore (ACTION SEE)¹ – përgatiti një vlerësim të gjendjes së qeverisjes së mirë të kuvendeve dhe degëve ekzekutive të qeverive qendrore të katër vendeve të Ballkanit Perëndimor - Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinës. Vlerësimi është rezultat i një studimi empirik gjithëpërfshirës të bazuar në Indeksin e hapjes², i cili synon të përcaktojë shkallën në të cilën respektohen parimet e qeverisjes së mirë në rajon. Përmes Indeksit të hapjes bëhet një analizë të thellë të punës së pushtetit ekzekutiv dhe të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por gjithashtu ofron edhe një përmbledhje të performancës së përgjithshme të institucioneve përkatëse në rajonin tonë. Perspektiva rajonale shërben si referencë për atë se si vendet në rajon po përparojnë drejt përmirësimit të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit që i çon ato drejt qëllimit të tyre strategjik - anëtarësimit në BE.

Analiza është pasuruar me rekomandime praktike për atë se si pushteti ekzekutiv i Maqedonisë së Veriut mund ta përmirësojë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në të ardhmen. Rekomandimet do t'u komunikohen nëpunësve të lartë shtetërorë në të gjitha institucionet e monitoruara përmes takimeve, si dhe publikut të gjerë përmes mediave sociale dhe përmes mbajtjes së ngjarjeve publike.

1 Llogaridhënie, Teknologji dhe Rrjet i Institucioneve të Hapura në Evropën Juglindore (ACTION SEE) është rrjeti i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku për të promovuar dhe për të siguruar përgjegjësi dhe transparencë të qeverive në rajonin e Evropës Juglindore, për ta rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, për t'i promovuar dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në internet dhe për t'i ndërtuar kapacitetet dhe interesin midis organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në rajon për përdorimin e teknologjisë në punë për promovimin e demokracisë.

2 Indeksi i Hapjes përbëhet nga katër komponentë të ndryshëm – (1) transparenca, (2) qasshmëria, (3) integriteti dhe (4) efikasiteti dhe secila prej tyre mat hapjen e një dege të veçantë të qeverisjes: pushtetit lokal, pushtetit qendror, gjyqësorit dhe kuvendit.

1. HYRJE

Komisioni Evropian në Raportin³ për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 vuri në dukje përpjekje intensive që çojnë në fillimin e procesit të negociatave të anëtarësimit. Mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare në korrik të vitit 2022 ishte një moment historik dhe shënoi një fazë të re të procesit të anëtarësimit në BE për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Maqedonia e Veriut i vazhdoi përpjekjet e saj për të forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, përkundër sfidave të caktuara. Nevojiten përpjekje për të përmirësuar transparencën në hartimin e politikave dhe gjithëpërfshirjen në proceset konsultative.

Në janar të vitit 2022, në Republikën e Maqedonisë së Veriut u zgjodh Qeveria e re, e cila u zotua “të udhëhiqet nga parimet themelore dhe të avancuara të qeverisjes së mirë, përkatësisht përgjegjësia, efikasiteti, llogaridhënia, puna e ndershme, gjithëpërfshirja dhe qasshmëria”⁴. Karakteristika që duhet theksuar në përbërjen e qeverisë së re është zgjedhja e Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes Mirë, funksion që është paraparë me qëllim që “krijimi dhe zbatimi i politikave të qeverisjes së mirë të jetë domosdoshmëri, në drejtim të garantimit të profesionalizmit, efikasitetit dhe transparencës në shoqëri”⁵.

Ky punim e analizon hapjen e institucioneve të qeverisë qendrore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022. Duke qenë se hapja është një kusht kyç për demokracinë, sepse u mundëson qytetarëve të marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efektive dhe llogaridhënie të institucioneve për politikën që i zbatojnë, në këtë punim, në bazë të analizës së situatës, institucioneve u jepen rekomandime se si ta përmirësojnë performancën e tyre.

Analizat dhe rekomandimet e paraqitura këtu do të shërbejnë si bazë për aktivitetet avokuese që do t'i ndërmarrë Fondacioni “Metamorfozis”, me qëllim të përmirësimit të parimeve të qeverisjes së mirë të institucioneve. Hulumtimi përsëritet çdo vit dhe na mundëson të krahasojmë shkallën e veprimit sipas rekomandimeve të dhëna më parë. Informacionet dhe të dhënat për rezultatet, individualisht dhe krahasuese, sipas institucioneve në Maqedoninë e Veriut dhe në vendet e rajonit, janë të disponueshme në faqen e internetit [Indeksi i hapjes së institucioneve rajonale \(cdtmn.org\)](https://www.cdtmn.org).

3 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 i Komisionit Evropian. Sekretariati për Çështje Evropiane. Shkarkuar nga <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

4 Programi për punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022–2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/WKKSjQK>.

5 Po aty.

2. METODOLOGJIA

Vlen të përmendet se megjithëse termi qeverisje e mirë përdoret shpesh në diskursin politik dhe në analizën e politikave, ai mbetet një koncept fluid, pa një përkufizim të qartë. Kuptimi i tij formohet, kryesisht, sipas qëllimit për të cilin përdoret dhe komponentët në të cilët fokusohet. Interpretimi i pranuar gjerësisht është se ky term i referohet sistemit të qeverisjes që jep rezultate që i plotësojnë nevojat e shoqërisë duke i shfrytëzuar burimet në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ky përkufizim korrespondon me standardet që zbatohen në demokracitë liberale përëndimore, të cilat, vendet në zhvillim, si Maqedonia e Veriut, i marrin si shembull dhe drejt të cilave synojnë.

Indeksi i Hapjes udhëhiqet nga kjo kornizë parimesh, por i merr parasysh zhvillimet kulturore dhe historike në vend dhe rajon që ndikojnë edhe te institucionet. Metodologjia e tij garanton që rezultatet e hulumtimit janë teknikisht dhe politikisht të vlefshme për të nxjerrë përfundime në lidhje me nivelin e qeverisjes së mirë së institucioneve në vend. Indeksi i Hapjes vlerëson performancën e pushtetit ekzekutiv dhe të parlamenteve në fushën e qeverisjes së mirë duke u fokusuar në katër shtylla: (1) qasshmëria, (2) efikasiteti, (3) integriteti dhe (4) transparenca, me një domen ndër-sektorial që është i pranishëm në të katër shtyllat - të dhënat e hapura.

Katër shtyllat e Indeksit të hapjes e përcaktojnë dhe e vlerësojnë qeverisjen e mirë së bashku me parimet e mëposhtme:

qasshmëria - e vlerëson shkallën në të cilën e drejta për qasje në informata garantohet nga ligji dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirjen dhe për konsultimin gjatë proceseve të hartimit të politikave;

efikasiteti - e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit – duke përdorur pika/tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit;

transparenca – e vlerëson disponueshmërinë publike të informacionit organizativ, buxhetin dhe procedurat e furnizimeve publike, ndërsa

integriteti e vlerëson praninë e mekanizmave për të parandaluar konfliktet e interesit, për të rregulluar lobimin, si dhe disponueshmërinë e kodit të sjelljes etike që do ta udhëheqë dhe sanksionojë sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe të administratës publike.

Çdo shtyllë e Indeksit përbëhet nga nënfusha dhe tregues të peshuar sipas vlerës adekuate brenda shtyllave.

Metodologjia u zhvillua duke u konsultuar me burime të shumta të besueshme, duke theksuar praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të qeverisjes së mirë, siç është Banka Botërore dhe Instituti, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Udhëzuesi i Qeverisë së Hapur, Raporti Global i Integritetit, dhe Treguesit e Qeverisjes dhe të Cilësisë Institucionale të zhvilluara nga Banka Botërore.

Hulumtimi është kryer në periudhën nga marsi deri në qershor të vitit 2023. Mostra e institucioneve të synuara përbëhet nga gjithsej 36 institucione, duke përfshirë Qeverinë/Sekretariatit e Përgjithshëm, 16 ministri dhe 19 organe ekzekutive të zgjedhura rastësisht në përbërje të ministrive. Metodatat e hulumtimit konsistojnë në (1) monitorimin e faqeve të internetit të institucioneve të synuara për një sërë treguesish, (2) një pyetësor të dorëzuar institucioneve për të konfirmuar vëzhgimet e monitorimit online, (3) një kërkesë të dërguar për qasje në informatat me karakter publik deri te çdo institucion me synimin për të

vlerësuar nivelin e respektimit të kësaj të drejte themelore nga çdo institucion si dhe (4) shqyrtimin e kornizës legjislative.

Gabimi i matjes është +/- 3%. Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kemi bërë një analizë të pikave dhe problemeve kyçe kritike në fushën e hapjes së institucioneve, të cilat shpresojmë se do të përdoren për përmirësimin e punës së tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se në rastet kur institucionet nuk kanë arritur t'i dorëzojnë pyetësorët e tyre të përgjigjur, treguesit e tyre janë shënuar me 0, si tregues të cilët nuk janë plotësuar. Në fakt, nga 36 institucione të synuara të pushtetit ekzekutiv, pyetësorit iu përgjigjën 22 (60%), ndërsa 14 të tjerat (40%) marrin automatikisht 0 sipas treguesve përkatës. Nga institucionet që nuk iu përgjigjën pyetësorit, 4 janë ministri (Ministria e Financave, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve) dhe 10 janë organe ekzekutive (Drejtoria e Policisë Financiare; Agjencia e Emigracionit; Enti Shtetëror i Statistikave; Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve; Arkivi Shtetëror; Sekretariati për Çështje Evropiane; Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Gjuetisë; Inspektorati Shtetëror i Arsimit; Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe Byroja për Ekspertizë Mjeko-Ligjore).

3. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3.1. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON

3.1.1 Hyrje

Koncepti i qeverisjes së hapur mbulon një spektër të gjerë politikash dhe praktikash, të cilat mund të çojnë në një mënyrë të re qeverisjeje, si nga perspektiva e qeverisë, ashtu edhe nga perspektiva e qytetarëve – mund të promovojë qeverisjen e mirë dhe të inkurajojë vendimmarrje më të mirë, reduktimin e korrupsionit dhe shërbime më efikase, të cilat autoritetet ua ofrojnë qytetarëve.⁶

Ndër karakteristikat kryesore të qeverisjes së hapur është transparenca, gjegjësisht disponueshmëria e informacionit dhe e të dhënave të nevojshme për kontrollin demokratik të organeve të autoriteteve publike. Përveç transparencës, parimet kryesore në të cilat bazohet qeverisja e hapur janë qasshmëria, efikasiteti dhe integriteti. Të udhëhequr nga këto parime, organizatat joqeveritare nga rajoni i Ballkanit Perëndimor – Qendra për Tranzicion Demokratik (CDT) nga Mali i Zi, Fondacioni “Metamorfozis” nga Maqedonia e Veriut, Partnerët për Ndryshim Demokratik Serbi (Partnerët Serbi) dhe Shoqata e Qytetarëve “Zashto ne?” (Pse jo?) nga Bosnja dhe Hercegovina (BdheH) e zhvillojnë instrumentin e tyre analitik – Indeksin Rajonal të Hapjes – i cili na jep të dhëna të besueshme për shkallën në të cilën institucionet i zbatojnë standardet e qeverisjes së mirë në punën e tyre.

Prandaj, Indeksi Rajonal i Hapjes mat se sa të hapura janë institucionet e autoriteteve ekzekutive ndaj qytetarëve dhe ndaj shoqërisë duke u bazuar në katër parime - transparenca, qasshmëria, integriteti dhe efikasiteti, dhe përmes këtyre dimensioneve shfaqet edhe një fushë shtesë - sa publikohen dhe përdoren të dhënat e hapura.

Qëllimi i aktiviteteve tona është të ofrojmë një analizë të situatës në fushën e hapjes dhe transparencës së punës së institucioneve të autoriteteve ekzekutive dhe të kontribuojmë në krijimin dhe zbatimin e reformave në këto fusha, duke ndërtuar marrëdhënie partneriteti me të gjitha institucionet.

Ky hulumtim po realizohet për të shtatin vit radhazi. Organizatat tona, pas çdo rrethi të hulumtimit, përpiqen të ndihmojnë proceset reformuese në vendet e tyre, të marrin pjesë në iniciativa të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare që i trajtojnë këto çështje dhe të bashkëpunojnë me institucionet, për të ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të transparencës dhe hapjes së autoriteteve. Secili vend në rajon ka kushtet e veta specifike politike në të cilat zhvillohen këto politika, por konsiderojmë se ka potencial të konsiderueshëm për bashkëpunim rajonal në këtë fushë.

Në këtë dokument, i prezantojmë rezultatet kryesore të hulumtimit për hapjes e pushteteve ekzekutive në vitin 2022/2023. Do t'i respektojmë parimet e transparencës së hulumtimit dhe do t'i njoftojmë institucionet me të gjitha detajet e realizimit të tij dhe konkluzionet e arritura.

6 Raporti i seancës së 35-të të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës në temën e “Transparencës dhe Qeverisjes së Hapur”, të datës 7 nëntor 2018.

3.1.2. Hapja e autoriteteve ekzekutive në rajon

Paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike në rajonin e Ballkanit Perëndimor ndikon si në zhvillimin e politikave ashtu edhe në kulturën e hapjes së autoriteteve. Megjithëse të gjitha vendet e rajonit janë të përkushtuara deklarativisht për përmirësimin e hapjes dhe transparencës, gjegjësisht për disponueshmëri më të madhe të informacionit për punën e autoriteteve publike, pjesëmarrjen e qytetarëve, digjitalizimin dhe përmirësimin e qasjes në shërbime, në realitet kjo po bëhet pak që publiku të mund ta kuptojë dhe ta kontrollojë punën e autoriteteve.

Rezultatet e monitorimit të këtij viti tregojnë se qeveritë në vendet e rajonit nuk kanë bërë progres të dukshëm në drejtim të transparencës proaktive dhe hapjes ndaj qytetarëve. Rezultatet më të mira në mesin e qeverive janë arritur nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila përmbush 79,14% të treguesve të hapjes, dhe Këshilli i Ministrave i BdheH, me përmbushje të 73,31% të treguesve të hapjes. Më pas, vijjnë Qeveria e Malit të Zi (68,87 %) dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (54,94 %), dhe në fund të listës janë Qeveria e Republikës Serbe (38,2 %), Qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës (37,57 %) dhe Qeveria e Krahinës Autonome të Vojvodinës (31,3 %). Kur bëhet fjalë për ministrinë, rezultatet më të mira, mesatarisht, i arrijnë ministrinë e Maqedonisë së Veriut, me përmbushje të 61,58 % të treguesve të hapjes. Në vendet e tjera, ministrinë plotësojnë më pak se gjysmën e treguesve të përcaktuar – 51,48%⁷ në Serbi, 45,48%⁸ në Mal të Zi, 37,40% në Bosnje dhe Hercegovinë. Organet e administratës në Maqedoninë e Veriut plotësojnë mesatarisht 54,04% të treguesve të hapjes, të ndjekura nga organet e administratës së Malit të Zi (43,63%), BdheH (38,27%) dhe Serbisë (35,10%).

Të dhënat e përmendura dëshmojnë se niveli i hapjes së autoriteteve ekzekutive ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Arsyet për këtë situatë gjenden në mungesën e vullnetit politik për rregullimin sistematik dhe zbatimin e politikave publike në këtë fushë. Një pengesë shtesë për zbatimin e reformave janë proceset e vazhdueshme zgjedhore, të cilat e paralizojnë punën e shumicës së institucioneve shtetërore. Gjatë vitit 2022 dhe gjysmës së parë të vitit 2023, secili nga katër vendet e përfshira në hulumtim mbajti zgjedhje dhe/ose kaloi nëpër proces të ristrukturimit të qeverisë. Në Mal të Zi, në periudhën nga shkurti deri në gusht të vitit 2022, Kuvendi i ka votuar dy herë mosbesim Qeverisë, e cila aktualisht funksionon me mandat teknik, ndërsa më 11 qershor 2023 janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Në Maqedoninë e Veriut u bënë dy rikonstruksione të Qeverisë në një periudhë më pak se dy vjeçare, të cilat sollën ndryshime kadrovike në ministri dhe në administratën shtetërore dhe i ngadalësuan ndjeshëm reformat. Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në BdheH u mbajtën në tetor të vitit 2022, pas të cilave pasoi procesi i formimit të qeverive në të gjitha nivelet. Në shumicën e rasteve, këto procese u ngadalësuan, kryesisht për shkak të kushtëzimeve politike në të gjitha nivelet, kështu që autoritetet në disa kantone ende nuk janë krijuar. Në Republikën e Serbisë, zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën në prill të vitit 2022. Megjithëse zgjedhjet nuk ndikuan ndjeshëm në fuqinë politike të partisë më të madhe në vend, qeveria e re nuk u formua deri në fund të tetorit të vitit 2022. Zgjedhjet e shpeshta e rëndojnë buxhetin, e ndërpresin veprimtarinë legjislativë dhe i ngadalësojnë reformat, gjë që duket edhe nga rezultatet e monitorimit të sivejtmë të hapjes.

7 Përqindja e fituar për ministrinë e Republikës së Serbisë duhet të merret me vëmendje të veçantë, sepse në vitin 2022 u formua Qeveria e re me shtatë ministri të reja (kjo ka të bëjë me ministrinë e sapoformuara dhe ministrinë që u krijuan në bazë të ndryshimit të fushëveprimit të punës, gjegjësisht transferimit të vendeve të punës). Metodologjia e hulumtimit duhet të përshtatet me situatën e re, kështu që hapja e këtyre ministrive u mat në bazë të një numri të reduktuar treguesish. Prandaj, rezultatet për këto ministri nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme me rezultatet për ministrinë e tjera, dhe ato janë përjashtuar nga Indeksi i hapjes së ministrive të Serbisë, i cili është llogaritur duke i marrë parasysh rezultatet e 18 ministrive që kanë vazhdimësi në punën e tyre dhe u bë e mundur që të hulumtohen praktikatat dhe puna e tyre në fushën e transparencës dhe hapjes.

8 Në këtë rreth të hulumtimit, hapja e Ministrisë së Çështjeve Evropiane është matur në bazë të një numri të reduktuar treguesish, duke pasur parasysh se për një periudhë të gjatë kohore nuk ka pasur një ministri të veçantë që merrej me çështjet evropiane, prandaj nuk ishte e mundur të kontrollohet nëse kjo ministri ka krijuar praktika të hapjes dhe transparencës në të njëjtën mënyrë sikurse edhe për ministrinë e tjera. Duke pasur parasysh këtë, indeksi i hapjes së ministrive të Malit të Zi është marrë duke përjashtuar rezultatet e arritura nga Ministria e Çështjeve Evropiane.

3.1.3. Politika e hapjes nuk është prioritet i shteteve të rajonit

Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë kryesisht të përkushtuara për të përmirësuar transparencën dhe hapjen e qeverive dhe organeve të administratës publike. Në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, këto fusha janë shënuar si prioritare, veçanërisht kur bëhet fjalë për përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit për punën e qeverive dhe informacionit për shpenzimin e fondeve shtetërore. Në të njëjtën kohë, vendet e rajonit paralajmërojnë digjitalizimin e administratave dhe qasjen më të lehtë në shërbime për qytetarët. Monitorimi që e bëjmë çdo vit tregon se këto vende nuk kanë bërë progres në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të hapjes.

Ciklet e fundit të monitorimit tregojnë se **Maqedonia e Veriut** ka përparuar më së shumti për sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike në fushën e transparencës dhe hapjes. Si vendi i parë në rajon që vendosi të rregullojë politikën e hapjes përmes një dokumenti të veçantë, Maqedonia e Veriut miratoi Strategjinë për Transparencë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut në vitin 2019. Megjithatë, zbatimi i strategjisë doli të ishte një sfidë. Përvoja e këtij vendi konfirmon se nuk mjafton vetëm planifikimi i aktiviteteve që do të çojnë në një transparencë më të madhe të autoriteteve, por është e nevojshme të vendoset një sistem i përshtatshëm monitorimi dhe vlerësimi, për të siguruar zbatimin cilësor të aktiviteteve të planifikuara. Në bazë të këtyre konkluzioneve, mësimet të nxjerra dhe zhvillimeve të reja në fushën e hapjes, me mbështetjen e Fondacionit “Metamorfozis” dhe ekspertëve të tjerë, Qeveria e Maqedonisë së Veriut po përgatit Strategjinë e re të Transparencës për periudhën 2023-2025.⁹ Gjithashtu, në fillim të vitit 2023, Agjencia për Qasje të Lirë në Informata e Maqedonisë së Veriut përgatiti udhëzime të detyrueshme për autoritetet publike për të përmirësuar transparencën në punën e tyre¹⁰. Ky dokument përmban një listë të informacioneve që më së shpeshti i kërkojnë qytetarët, të ndarë në 37 fusha. Dokumenti i detyron autoritetet publike që brenda 6 muajve t’i publikojnë të gjitha informatat që i zotërojnë, të sistemuara sipas fushave, si dhe t’i publikojnë të gjitha përgjigjet që japin për kërkesat për qasje të lirë në informata. Edhe pse është për t’u lavdëruar ajo që Maqedonia e Veriut po merr masa për të krijuar politika të hapjes dhe transparencës, duhet të bëhen përpjekje më të forta për zbatimin e këtyre akteve.

Në fund të vitit 2018, Këshilli i Ministrave të **BdheH**, me propozim të Zyrës së Koordinatorit për Reformat e Administratës Publike, miratoi Politikën dhe Standardet për Transparencë Proaktive dhe i detyroi të gjitha institucionet e Këshillit të Ministrave të BdheH që të përditësojnë rregullisht të dhënat e publikuara në faqet e tyre të internetit. Disa nga institucionet kanë shënuar progres pas miratimit të politikave dhe standardeve të mësipërme, por, siç tregojnë rezultatet e këtij hulumtimi rajonal, ende ekziston nevoja për të përmirësuar hapjen dhe transparencën e përgjithshme të institucioneve në këtë vend. Konkluzioni i ri i Këshillit të Ministrave të BdheH nga viti 2022 i detyron institucionet e BdheH të miratojnë akte/rregullore të brendshme për publikimin proaktiv të informacionit me interes publik. Sipas të dhënave në dispozicion, deri më tani këto akte janë miratuar nga 30 nga 65 institucione.¹¹

Edhe pse Bosnja dhe Hercegovina ishte vendi i parë në rajon që e miratoi Ligjin për Qasjen e Lirë në Informacion në vitin 2001, zbatimi i plotë i ligjit nuk u arrit kurrë, ndërsa Propozim-ligji i ri për Lirinë e Qasjes në Informacion e redukton nivelin e të drejtës për qasje në informatat me karakter publik. Organizatat civile në BdheH vazhdimisht kanë theksuar dëmin e këtyre dispozitave dhe kanë paraqitur më shumë se 200 propozime për Propozim-ligjin, por Ministria e Drejtësisë e BdheH nuk ka pranuar asnjë prej tyre.¹²

9 Fondacioni Metamorfozis: https://metamorphosis.org.mk/en/aktivnosti_arhiva/by-supporting-the-process-of-creating-the-strategy-for-transparency-of-the-government-metamorphosis-will-contribute-to-the-advancement-of-the-transparency-process-of-the-government-and-the-institutio/

10 Qendra për Menaxhim me Ndryshimet: https://cup.org.mk/publication/%D0%A3%D0%BF%D0%B0%D1%82%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE_mkd%20%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%BE.pdf

11 Zyra e Koordinatorit për Reformat e Administratës Publike në Bosnjë dhe Hercegovinë: <https://parco.gov.ba/hr/2023/06/13/cuzulan-i-cuzic-potrebno-je-jos-intenzivnije-i-sistematicnije-raditi-na-promociji-standarda-i-principa-proaktivne-transparentnosti/>

12 Transparency International BiH, organizatat e shoqërisë civile paralajmërojnë: Propozim-ligji për Qasjen e Lirë në Informacion do t’i rrezikojë të drejtat e qytetarëve: <https://ti-bih.org/organizacije-civilnog-drustva-upozoravaju-prijedlog-zakona-o-slobodi-pristupa-informacijama-ce-ugroziti-prava-gradjana/>

Në **Mal të Zi**, ligjet dhe dokumentet strategjike që e rregullojnë transparencën dhe hapjen presin një qeveri të re dhe një elitë politike më të përgjegjshme.

Tri qeveritë e mëparshme paralajmëruan ndryshime në Ligjin për Qasje të Lirë në Informacion, por ky proces nuk u përfundua kurrë. Propozim-ligji, i cili parashikon përmirësime të ndjeshme krahasuar me atë ekzistuesin, ka ngecur në procedurë parlamentare; me atë që përmban kufizime shumë më të rrepta për qasjen në të dhënat e inteligjencës-sigurisë. Kufizimet në zbatimin e ligjeve, të tilla si sekretet e biznesit apo ato tatimore, kanë rezultuar të jenë veçanërisht të kontestueshme në praktikë, gjë që le hapësirë për keqpërdorim dhe fshehje të informatave me karakter publik.

Edhe pse u paralajmërua, Ligji për Qeverinë mbeti vetëm në formë drafti. Propozimet e Qendrës për Tranzicion Demokratik (QDT), të cilat do të sigurojnë transparencë më të madhe të procesit të vendim-marrjes së Qeverisë, u pranuan gjatë hartimit të Ligjit. Kështu, në Propozim-ligji hyri edhe detyrimi për publikimin e rendit të ditës së seancave të Qeverisë, duke përfshirë edhe emrat (shenjat) e materialeve të shënuara me shkallë të fshehtësisë; publikimi i materialeve të propozuara për çdo pikë në rendin e ditës të seancave, përveç atyre të shënuara me shkallën përkatëse të fshehtësisë; publikimi i materialeve dhe vendimeve të miratuara nga Qeveria në seancat telefonike; publikimi i procesverbaleve të seancave të Qeverisë.¹³ Mbetet të shihet nëse hartimi i Ligjit për Qeverinë do të jetë prioritet i qeverisë së re dhe nëse transparenca e seancave të saj do të rregullohet në mënyrën e mësipërme.

Qeveria e Malit të Zi nuk ka punuar në zhvillimin e strategjive të veçanta që do të përmirësonin hapjen dhe transparencën e autoriteteve ekzekutive, me përjashtim të aktiviteteve për zhvillimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Administratë të Hapur.

Në **Serbi** nuk ka strategji të veçanta që do t'i referoheshin ekskluzivisht hapjes dhe transparencës së organeve shtetërore. Megjithatë, përmes strategjive sektoriale dhe strategjive për zhvillimin e organeve të administratës, transparenca dhe digjitalizimi i administratës shpesh përmenden si prioritet. Edhe në ekspozenë e Qeverisë së Serbisë nga viti 2022, thuhet se një nga pesë prioritetet e Qeverisë është vazhdimi i digjitalizimit dhe zhvillimi i robotikës dhe inteligjencës artificiale¹⁴. Serbia nuk ka bërë përparim të dukshëm në fushën e transparencës së punës së organeve të autoriteteve publike, as sipas rezultateve të hulumtimit rajonal e as sipas raporteve të Komisionerit për Informatat me Karakter Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga pikëpamja normative, Ligji i ri për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik krijoi kushte për të hequr disa nga problemet kryesore në këtë fushë, siç është pamundësia e ekzekutimit administrativ të vendimit të Komisionerit, megjithatë, lihet hapësirë dhe për abuzime të reja të të drejtave, dhe për këtë arsye institucioni i Komisionerit kërkon ndryshime të reja në ligj¹⁵.

13 Propozim-ligji për Qeverinë. Gjetet në: <https://www.gov.me/dokumenta/497c3769-17b1-4c03-85e8-afb406ea4067>.

14 Ekspozija e Qeverisë së Serbisë, tetor 2022: <https://www.srbija.gov.rs/tekst/330252/ekspoze.php>

15 <https://www.paragraf.rs/dnevne-vesti/260922/260922-vest6.html>

3.1.4. Partneriteti për Qeverisje të Hapur – një mundësi apo shans i humbur

Të gjitha vendet e përfshira në monitorim marrin pjesë në nismën ndërkombëtare të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH),¹⁶ qëllimi i të cilit është të sigurojë mbështetje dhe angazhim më të madh të qeverive në mbarë botën, në mënyrë që të përmirësohet integriteti, transparencja, efikasiteti dhe përgjegjësia e shteteve. Maqedonia e Veriut është në përfundim të zbatimit të Planit të pestë Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur për periudhën 2021-2023, dhe në të njëjtën kohë filloi procesin e përgatitjes së Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur për periudhën 2024-2026. Plani aktual i veprimit përmban 23 angazhime ambicioze, veçanërisht në lidhje me transparencën e prokurimeve publike, ofrimin e shërbimeve publike dhe qasjen në drejtësi për grupet e cenueshme. Faqja e internetit e PQH-së thekson se zbatimi i plotë i Planit të Veprimit mund ta pozicionojë Maqedoninë e Veriut si lider në Ballkanin Perëndimor në fushën e hapjes.¹⁷ Bosnja dhe Hercegovina deri më tani ka zhvilluar dy plane kombëtare veprimi. I pari, për periudhën 2019-2021, pati sukses të kufizuar dhe shumica e zotimeve u përmbushën vetëm pjesërisht.¹⁸ Plani i dytë i Veprimit, për periudhën 2021-2023, u miratua vetëm në fund të vitit 2022, që e ilustron nivelin e përkushtimit të shtetit për zbatimin e reformave në fushën e hapjes.¹⁹ Mali i Zi ka qenë joaktiv në Partneritet për disa vite, për këtë arsye kishte rrezik për përjashtim nga anëtarësimi. Ata kanë pritur dy vite të tëra për përgatitjen e Planit të tretë të Veprimit. Në dhjetor të vitit 2022, Qeveria e Malit të Zi miratoi një Plan të ri Kombëtar të Veprimit për periudhën 2023-2024.²⁰ Në Serbi, procesi i zhvillimit të Planit të pestë të Veprimit është në vazhdim. Plani i fundit i veprimit u fokusua në digjitalizimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Gjysma e angazhimeve ishin përfunduar plotësisht ose thelbësisht, por vetëm një (thjeshtimi i procedurave administrative) pati një ndikim të rëndësishëm transformues në përmirësimin e hapjes së administratave²¹. Rekomandimet për planet e ardhshme të veprimit, të shënuara në raportin e pavarur, i referohen kryesisht mbështetjes më të madhe nga kulmi i pushtetit ekzekutiv për planifikimin dhe zbatimin e planeve të veprimit.

PQH-ja është një mundësi për shoqërinë civile dhe për shtetet që së bashku të krijojnë prioritetet që duhet të kontribuojnë në forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje, luftën kundër korrupsionit, qasjen më të thjeshtë në informacione dhe shërbime, etj., të gjitha këto me synimin për të pasur punë më efektive më të përgjegjshme të autoriteteve publike. Prandaj, është e nevojshme që planet e veprimit të përmbajnë angazhime që i synojnë këto fusha dhe të kenë potencial transformues, kurse parakushti kryesor për sukses është përkushtimi i qartë i qeverive për zbatimin e planeve të veprimit në vepër.

16 Partneriteti i Qeverisjes së Hapur: <https://www.opengovpartnership.org/>

17 Në këtë rreth të hulumtimit, hapja e Ministrisë së Çështjeve Evropiane është matur në bazë të një numri të reduktuar treguesish, duke pasur parasysh se për një periudhë të gjatë kohore nuk ka pasur një ministri të veçantë që merrej me çështjet evropiane, prandaj nuk ishte e mundur të kontrollohet nëse kjo ministri ka krijuar praktika të hapjes dhe transparencës në të njëjtën mënyrë sikurse edhe për ministrinë e tjera. Duke pasur parasysh këtë, indeksi i hapjes së ministrive të Malit të Zi është marrë duke përjashtuar rezultatet e arritura nga Ministria e Çështjeve Evropiane, Maqedonia e Veriut <https://www.opengovpartnership.org/members/north-macedonia/>

18 Mekanizmi i Hulumtimit të Pavarur (MHP), Raporti i Përkohshëm për Rezultatet e Bosnjës dhe Hercegovinës 2019-2021 <https://www.opengovpartnership.org/documents/bosnia-and-herzegovina-transitional-results-report-2019-2021/>

19 Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Bosnje dhe Hercegovina <https://www.opengovpartnership.org/members/bosnia-and-herzegovina/>

20 Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Mali i Zi: <https://www.opengovpartnership.org/members/montenegro/>

21 Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Serbi: <https://www.opengovpartnership.org/documents/serbia-results-report-2020-2022/>

3.1.5. Asnjë mbikëqyrje të informacionit konfidencial

Për të dytin vit radhazi, përmes këtij hulumtimi, mblidhen informacione për numrin e të dhënave që autoritetet publike i shënojnë me shenja të konfidencialitetit. Arsyeja për këtë është fakti se pikërisht konfidencialiteti përdoret shpesh si argument për fshehjen e informacionit që janë me karakter publik. Këtë vit u përpoqëm të përcaktojmë se si vendet e rajonit kryejnë mbikëqyrjen mbi zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me konfidencialitetin e të dhënave. Rezultatet janë shqetësuese dhe kërkojnë reagime urgjente.

Megjithatë, një numër i madh i organeve të autoriteteve publike në vendet e rajonit ende refuzojnë të japin informacion për numrin e të dhënave që i kanë shënuar si konfidenciale, pavarësisht se publikimi i këtyre të dhënave nuk mund t'i kërcënojë interesat e sigurisë së shteteve. Nga 241 organe ekzekutive dhe legjislative të cilave u janë dërguar kërkesat për qasje në informata me karakter publike, 25 kanë refuzuar të japin informacion, dhe madje 57 nuk u janë përgjigjur fare kërkesave. Sa i përket mbikëqyrjes, në bazë të përgjigjeve të institucioneve, konstatohet se mbikëqyrja mbi konfidencialitetin e të dhënave në rajonin e Ballkanit Perëndimor pothuajse nuk zbatohet fare. Kjo krijon dy probleme serioze. Aty ku nuk ka mbikëqyrje, informacioni mund të klasifikohet arbitrarisht si konfidencial, duke rrezikuar kështu të drejtën e qytetarëve për qasje në informacione me karakter publik dhe duke penguar mundësinë e rishikimit të punës së organeve shtetërore. Së dyti, pa një sistem adekuat kontrolli dhe mbikëqyrjeje, mund të ketë zbulim ose keqpërdorim të të dhënave sekrete që ligjërisht janë të përcaktuara si sekrete, që mund të kontribuojë në rrezikimin e sigurisë kombëtare ose publike, mbrojtjes dhe interesave të tjera të rëndësishme të shteteve dhe të qytetarëve të tyre. Edhe pse asnjë nga katër vendet nuk ka një pozicion të mirë në këtë fushë, situata në Serbi është më alarmante, sepse mbikëqyrja e konfidencialitetit të të dhënave nuk kryhet fare, e numri i të dhënave të shënuara si sekrete vetëm në vitin 2022 është më shumë se 1.400.000. Më poshtë janë të dhënat për çdo shtet.

Në **Serbi**, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e konfidencialitetit të të dhënave. Përgjigja e Ministrisë ndaj kërkesës për qasje në informacion tregon se Ministria nuk kryen asnjë mbikëqyrje në fushën e konfidencialitetit të të dhënave, me arsyetimin se në praktikë ka pasur problem me zbatimin e dispozitave të mbikëqyrjes të Ligjit për Konfidencialitetin e Dhënave, të cilat janë të karakterit sistemor dhe kërkojnë ndryshim të ligjit²². Ky nuk do të ishte një problem aq i madh, nëse në shtator të vitit 2020 nga Ministria nuk do të merrej e njëjta përgjigje si në dhjetor të vitit 2017, që do të thotë se Ministria nuk ka marrë masa për eliminimin e problemeve të vërejtura në praktikë për më shumë se pesë vjet. Kjo është një e dhënë alarmante nëse kombinohet me informacionin për numrin e të dhënave të shënuara si konfidenciale në Serbi gjatë vitit 2022. Bazuar në një mostër prej 73 organesh të autoriteteve publike, ku përfshihen të gjitha ministritë, dy qeveri, dy kuvende dhe një mostër prej 44 organesh të administratës, arrijmë në një shifër prej më shumë se 1.400.000 të dhënash të shënuara si konfidenciale. Duhet të theksohet se mostra nuk i përfshin të gjitha autoritetet në Serbi dhe se Qeveria e Republikës së Serbisë, Agjencia e Sigurisë Ushtarake dhe Agjencia e Inteligjencës Ushtarake refuzuan të përgjigjen, që do të thotë se numri i të dhënave të shënuara si konfidenciale vetëm në vitin 2022 është shumë më i madh.

Ministria e Sigurisë së **Bosnjë dhe Hercegovinës** ka refuzuar të japë informacion mbi mbikëqyrjen e kryer dhe aktivitetet në fushën e konfidencialitetit të të dhënave. Në vendimin e dërguar, ata theksojnë se publikimi i këtyre informacioneve mund të dëmtojë objektivat legjitime të Bosnjës dhe Hercegovinës në lidhje me interesat e sigurisë. Kjo përgjigje bie ndesh me parimet bazë mbi të cilat bazohet e drejta për qasje të lirë në informatat me karakter publik, të cilat ekzistojnë në mënyrë që publiku të ketë një pasqyrë në punën e organeve të autoriteteve publike. Informacioni për numrin e mbikëqyrjeve të kryera është informacion mbi bazën e të cilit publiku mund të vërë në dyshim punën dhe përgjegjësinë e organeve

22 Partnerët Serbi: <https://www.partners-serbia.org/post?id=526>

që, në përputhje me ligjet, duhet t'i zbatojnë kompetencat e tyre. Me këtë mënyrë të veprimit të krijuhet përshtypja se institucionet po fshehin diçka ose se nuk po e bëjnë punën e tyre, gjë që krijon mosbesim shtesë tek qytetarët në punën e institucioneve dhe krijon perceptim se institucionet nuk i mbrojnë interesat e qytetarëve. Nga 98 organe të autoriteteve publike në BdeH, të cilave iu dërgua kërkesë për qasje në informata, 31 organe refuzuan të japin informacionin e kërkuar. Në bazë të institucioneve që kanë dhënë përgjigje, arrijmë në një shifër prej 1.651 të dhënash të shënuara si konfidenciale në vitin 2022. Megjithatë, është e vështirë të jepet një numër i përafërt i të dhënave që aktualisht janë shënuar si konfidenciale nga autoritetet ekzekutive dhe legjislative, sepse informacionet, ndër të tjerët, refuzuan t'i dorëzojnë Qeveria e Republikës Serbe, Parlamenti i BdeH - Dhoma Përfaqësuese, Parlamenti i BdeH - Dhoma e Popullit, Parlamenti i FBdeH - Dhoma e Përfaqësuesve, si dhe një pjesë e ministrive me kompetenca në fushën e punëve të brendshme dhe të sigurisë, gjë që ndikon që pasqyra për atë se sa të dhëna në BdeH janë shënuar si konfidenciale, të mbetet e paplotë.

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Konfidenciale e Malit të Zi ka dorëzuar informacione për aktivitetet në fushën e mbikëqyrjes së konfidencialitetit të të dhënave. Në përgjigje kanë thënë se gjatë vitit 2022 kanë kryer 12 mbikëqyrje të rregullta dhe 7 mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese, në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Malit të Zi dhe në aeroportet e Malit të Zi.

Nga 33 organet e autoriteteve të cilave iu është dërguar kërkesa për informata mbi numrin e të dhënave të shënuara si konfidenciale në vitin 2022, gjashtë nuk iu përgjigjën kërkesës. Në bazë të përgjigjeve të institucioneve, arrijmë në përfundimin se Ministria e Mbrojtjes posedon numrin më të madh të dokumenteve të shënuara me njëfarë niveli të konfidencialitetit, 3.502 prej tyre.²³

Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara e **Maqedonia e Veriut**, në përgjigje të kërkesës, i është referuar raportit të saj të punës. Në pjesën e raportit që i referohet mbikëqyrjes inspektuese, thuhet se institucioni në vitin 2022 nuk ka kryer mbikëqyrje të rregullta inspektuese për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore, por se ka kryer katër mbikëqyrje të jashtëzakonshme në bazë të raporteve, një prej të cilave ka rezultuar me ngritjen e kallëzimit penal. Nga mostra prej 37 institucioneve, 29 institucione kanë dorëzuar informacion për numrin e të dhënave të shënuara si konfidenciale. Këto institucione kanë shënuar si konfidenciale gjithsej 142.182 të dhëna.

Argumenti se institucioni nuk ka punonjës të mjaftueshëm, prandaj nuk mund të kryejë mbikëqyrje inspektuese, është një rast i shpeshtë në vendet e rajonit, të cilat në këtë mënyrë e justifikojnë mospunën e tyre. Është e nevojshme që shtetet të kenë sisteme për të kontrolluar institucionet, e veçanërisht të rëndësishme janë mekanizmat për kontrollin dhe mbikëqyrjen e degës ekzekutive të pushtetit në fushat ku keqpërdorimet janë të shpeshta.

23 Në përgjigje të kërkesës për qasje të lirë në informata, Ministria e Punëve të Brendshme u përgjigj se janë 208 të dhëna që janë shënuar me njëfarë niveli të konfidencialitetit (197 "të brendshme", 7 "konfidenciale" dhe 4 "sekrete"). Ministria e Çështjeve Evropiane u përgjigj se janë nëntë lëndë që janë shënuar si "të brendshme" dhe në to 69 dokumente janë "të brendshme" dhe se nga institucionet tjera kanë marrë 10 dokumente të shënuara si "të brendshme", Ministria e Ekologjisë, Planifikimit Hapësinor dhe Urbanizmit u përgjigj se dy të dhëna janë të shënuara me shkallën "të brendshme", dhe një me shkallën "sekrete", Ministria e Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik ka një "të brendshme", Administrata e Burimeve Njerëzore ka gjashtë "të brendshme". Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Malit të Zi është përgjigjur se ka miratuar një vendim me të cilin të dhënat shënohen me nivelin "të brendshme".

3.1.6. Ende nuk dihen informacionet bazë për punën e autoriteteve

Që qytetarët të fitojnë besimin në punën e institucioneve, është e nevojshme të përmirësohet komunikimi ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Sot ajo i referohet kryesisht komunikimit përmes faqeve të internetit të institucioneve dhe rrjeteve sociale, si dhe trajtimit të kërkesave për qasje në informacion.

Fatkeqësisht, rezultatet e monitorimit rajonal të këtij viti tregojnë se shumica e institucioneve të mostrës ende nuk publikojnë informacion bazë për punën e tyre, si p.sh. raportet vjetore të punës, raportet vjetore financiare, informacionet për emrat dhe rrogat e punonjësve në institucione etj.

Rezultatet janë edhe më të këqija kur bëhet fjalë për pyetëtorin që tradicionalisht çdo vit ua dërgojmë institucioneve si pjesë e këtij hulumtimi. Pyetëtori plotësohet në baza vullnetare dhe këtë vit atë e kanë plotësuar vetëm 40% e institucioneve të përfshira në mostër. Duke e parë këtë si një nga treguesit dhe nivelin e bashkëpunimit të institucioneve me sektorin civil, mund të konstatohet se më shumë se gjysma e institucioneve nuk e konsiderojnë të rëndësishëm bashkëpunimin me sektorin civil.

Publikimi i të dhënave në format të lexueshëm nga makina është një tjetër tregues me të cilin matim progresivitetin e institucioneve në fushën e qasjes në të dhënat. Megjithëse përdorimi i të dhënave të hapura është promovuar prej vitesh dhe shumica e vendeve të rajonit kanë portalet të veçanta për të dhënat e hapura, në faqet e internetit të institucioneve nuk u gjetën të dhëna të në format të lexueshëm nga makina dhe në format të hapur, siç janë formatet XML, CSV, JSON. Duke i hapur të dhënat, institucionet ofrojnë një nivel më të lartë të transparencës në punën e tyre, ndërsa në të njëjtën kohë u japin qytetarëve dhe bizneseve mundësi të reja për të krijuar vlera të reja nga të dhënat – qofshin ato për ndonjë aplikacion të ri, model biznesi, vizualizim, hartë, projekt hulumtues etj.

U bëjmë thirrje qeverive në rajon që të vendosin hapjen dhe transparencën si fusha prioritare të mandateve të tyre dhe të zbatojnë reformat e nevojshme për të përmirësuar situatën në këto fusha.

Krahas kësaj analize, ne kemi përgatitur edhe një udhëzues me udhëzime dhe sugjerime për përmirësimin sistematik të situatës në fushën e transparencës proaktive.²⁴

Duke përdorur afërsisht 40 deri në 100 tregues, në varësi të institucionit, e kemi matur dhe analizuar hapjen e 232 institucioneve të autoriteteve ekzekutive. Hulumtimi është kryer në periudhën nga marsi deri në fund të qershorit 2023. Gabimi i matjes është +/- 3%. Në bazë të rezultateve të hulumtimit, kemi bërë këtë analizë, e cila shpresojmë se do të jetë e dobishme për përmirësimin e punës dhe praktikave të institucioneve në fushën e hapjes dhe transparencës.

24 Publikimi proaktiv i informacionit: Udhëzime dhe praktika: <https://www.cdtmn.org/wp-content/uploads/2023/04/Proaktivni-pristup-informacijama-Smjernice-i-Prakse-25.02..pdf>

3.2 PËRMBLEDHJE PËR PUSHTETIN EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Rezultati i përgjithshëm i pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut (Qeveria, ministrinë dhe organet ekzekutive) sipas Indeksit të Hapjes arrin në 64,92% përmbushje të treguesve të hapjes.

Hapja sipas grupeve të institucioneve



Krahasuar midis grupeve të institucioneve (Qeveria, ministrinë dhe organet ekzekutive), **më e hapura është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila përmbush 79,14% të kriterëve të përcaktuara për hapje.** Më pas vijnë ministrinë që plotësojnë 61,58% të treguesve, e pastaj organet ekzekutive që kanë rezultatin më të ulët sipas Indeksit, gjegjësisht 54,04% përmbushje të treguesve. Analizuar nga këndvështrimi rajonal, mesatarja e qeverive është 59,9% përmbushje e treguesve, rezultati është shumë i mirë, sepse për katër vite me radhë Qeveria e Maqedonisë së Veriut është në vendin e parë në rajon për nga përmbushja e treguesve.

Vihet re se **8 ministri**, duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrinë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, **janë nën mesataren e ministrive që plotësojnë 61,58% të treguesve të hapjes.**


Përfundimi i përgjithshëm që rezulton nga institucionet e monitoruara në Indeksin e Hapjes, i cili përsëritet disa vite me radhë, është **ekzistenca e një korrelacioni të drejtpërdrejtë midis hierarkisë së institucioneve dhe rënies së vlerësimit të tyre.** Që do të thotë se angazhimi dhe aplikimi i standardeve të hapjes janë në nivele të ndryshme të struktura të ndryshme të pushtetit ekzekutiv dhe për këtë arsye koncepti i hapjes duhet të trajtohet në mënyrë sistematike. Prandaj, politikat qendrore si Strategjia e Transparencës dhe standardet minimale të vendosura për transparencën dhe llogaridhënien publike duhet të pranohen dhe të zbatohen nga të gjitha institucionet e pushtetit qendror.

Top 3 institucionet e hapura në Maqedoninë e Veriut



Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve, **Ministria e Mbrojtjes (89,72%)** është institucioni lider në përmbushjen e treguesve të hapjes, e më pas vijon **Qeveria (79,14 %)** dhe **Ministria e Punëve të Brendshme (78,9 %)**.

Pushteti ekzekutiv – hapja sipas nënkategorive




Analiza e bazës së të dhënave të Indeksit të Hapjes, e ndarë në katër nënkategori (**transparenca, integriteti, qasshmëria dhe efikasiteti**) tregon se rezultati total i pushtetit ekzekutiv arrin **vlerësimin më të lartë prej 60,44% të përmbushjes së treguesve të transparencës** (si edhe vitin e kaluar), ndërsa **vlerësim më të ulët për efikasitetin prej 52,82%**. Treguesit e efikasiteti - e shqyrtojnë përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit - duke përdorur pika/tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit.

Prandaj, **përfundimi** është se është nevojshme të zbatohet roli i Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të politikave ekzistuese. Gjithashtu, rekomandohet që institucionet të përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit, si dhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.

Nga analiza e treguesve në **nënkategorinë e transparencës** është vënë re se **transparencës** e pushtetit ekzekutiv me **60,44%** të përmbushjes së treguesve është rritur për 6% krahasuar me vitin e kaluar. Të analizuar individualisht, organet ekzekutive janë në fund të shkallës për sa i përket përmbushjes së treguesve të transparencës me 55,26%, pastaj ministrinë me 58,83% dhe në vend më të larta është qeveria me 67,76% përmbushje të treguesve të transparencës.

TRANSPARENCA – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve




Nënkategoria e transparencës: Top 3 institucionet në Maqedoninë e Veriut



Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve në nënkategorinë e transparencës, Ministria e Mbrojtjes (78,23%) renditet e para, e ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë (70,65%) dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut (69,18%). Duhet theksuar se në nivel rajonal në këtë nënkategori, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut renditet e para.

Nga analiza e treguesve në **nënkategorinë e integritetit** pushteti ekzekutiv ka realizim prej **59,02%** të përmbushjes së treguesve. Të analizuar individualisht, në vend më të lartë janë ministritë me 70,25%, pastaj Qeveria me 64,71% e më poshtë në renditje janë organet ekzekutive me 42,1% përmbushje të treguesve të integritetit.

INTEGRITETI – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Nënkategoria e integritetit: Top 7 institucionet në Maqedoninë e Veriut



100%

Ministria e Mbrojtjes




84%

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Arsimit
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Drejtësisë

Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve në nënkategorinë e integritetit, vendin e parë e zë Ministria e Mbrojtjes me përmbushje 100% të treguesve, kurse vendin e dytë e ndajnë 6 ministri me përmbushje prej 84% të treguesve, konkretisht: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Drejtësisë. Duhet theksuar se në nivel rajonal në këtë nënkategori, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut renditet e para.

Nga analiza e treguesve në **nënkategorinë e qasshmërisë** pushteti ekzekutiv arrin një vlerësim mesatar prej **52,94%** të përmbushjes së treguesve. Për vlerësimin mesatar ndikon përmbushja e ulët e treguesve të qasshmërisë nga ministrinë (41,54 %) dhe nga organet ekzekutive (41,96 %), të cilët janë nën vlerësimin e përgjithshëm mesatar në nënkategorinë e qasshmërisë. Për dallim prej tyre, qeveria plotëson 75.31% të treguesve të qasshmërisë.

QASSHMËRIA – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve




Nënkategoria e qasshmërisë: Top 3 institucionet në Maqedoninë e Veriut



Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve në nënkategorinë e qasshmërisë, e para është Qeveria (75,31%), e ndjekur nga Ministria e Mbrojtjes (63,85%) dhe Byroja e Sigurisë Publike (62,67%). Nga analiza e treguesve në **nënkategorinë e efikasitetit** pushteti ekzekutiv ka realizim prej **52,82%** të përmbushjes së treguesve. Të analizuar individualisht, organet ekzekutive edhe në këtë kategori anë në fund të shkallës për sa i përket përmbushjes së treguesve të efikasitetit me 38,42%, më lartë janë ministritë me 53,43% përmbushje të treguesve dhe në vend më të lartë është qeveria me 66,6% përmbushje të treguesve të efikasitetit.

EFIKASITETI – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Nënkategoria e efikasitetit: Institucionet e renditura të para në Maqedoninë e Veriut



90%


Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave
Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik
Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit
Byroja e Sigurisë Publike

Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve në nënkategorinë e efikasitetit, vendin e parë e ndajnë 7 ministri dhe 3 organe ekzekutive me një përmbushje prej 90% të treguesve, edhe atë. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtarin dhe Urbanizëm dhe Byroja e Sigurisë Publike.

Të dhënat e hapura në këtë hulumtim vëzhgohen si një shtyllë e përbashkët e qeverisjes së mirë duke vlerësuar shkallën e hapjes së të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të shqyrtuara përmes Indeksit të Hapjes. Indeksi rajonal tregon rezultatet më të mira për Maqedoninë e Veriut, megjithëse pushtet i ekzekutiv ka një përmbushje modeste prej 38,81% të treguesve. Individualisht Qeveria përmbush 46,36%, organet ekzekutive 41,01%, ndërsa ministritë përmbushin 35,09% të treguesve të të dhënave të hapura.

Të dhëna të hapura – veçmas sipas grupeve të institucioneve



Të dhënat e hapura: Top 3 institucionet në Maqedoninë e Veriut




Nga matja individuale e gjithsej 36 institucioneve për sa i përket plotësisht të treguesve që matin disponueshmërinë e të dhënave të hapura, e para renditet Ministria e Mbrojtjes me 58,03%, më pas Byroja e Zhvillimit Rajonal me 52,8% dhe i treti renditet Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor me 50,16%.

Përfundim i përgjithshëm nga Indeksi i Hapjes është se Republika e Maqedonisë së Veriut ka përparuar më së shumti sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike në fushën e transparencës dhe hapjes. Është shteti i parë në rajon që d rregullon politikën e hapjes përmes një dokumenti të veçantë, Strategjisë për transparencë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, qysh në vitin 2019 dhe këtë praktikë e ka vazhduar edhe në vitin 2022. Por, nga ana tjetër, duke pasur parasysh se pikat e indeksit për qasshmërinë e vlerësojnë shkallën në të cilën e drejta për qasje në informata realizohet në praktikë dhe e vlerësojnë cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultim në proceset e hartimit të politikave, është i nevojshëm zbatim efikas i politikave ekzistuese nga ministritë dhe organet ekzekutive.

Prandaj, qeveria, por edhe çdo institucion veç e veç, mund të udhëhiqet nga Indeksi i Hapjes dhe ta përdorë atë si një mjet për të avancuar qeverisjen e mirë të saj. Fokusi i institucioneve duhet të jetë në publikimin proaktiv të të gjitha dokumenteve në formatin më të hapur të disponueshëm. Rrjedhimisht, faqet e internetit duhet të zënë një pozicion qendror në të gjitha politikat e hapjes së institucioneve, në mënyrë që të përmirësohet disponueshmëria, si dhe cilësia e informacionit dhe e të dhënave.

3.3. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQEDONINË E VERIUT



Në matjen e këtij viti të Indeksit të hapjes, krahasuar midis grupeve të institucioneve (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive), më e hapura është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila përmbush 79,14% të kriterëve të përcaktuara për hapje. Krahasuar me vitin e kaluar, Qeveria ka një rënie të tepër të vogël në përmbushjen e kriterëve. Megjithatë, analizuar nga pikëpamja rajonale, mesatarja e qeverive në përmbushjen e treguesve është 59,9%, rezultati është shumë i mirë, sepse për katër vite me radhë Qeveria e Maqedonisë së Veriut është në vendin e parë në rajon në përmbushjen e treguesve, e kjo gjithashtu korrespondon me përkushtimin e Qeverisë së Maqedonisë që të fokusohet në digjitalizimin e proceseve të institucioneve, me qëllim të krijimit të sistemeve efikase dhe efektive të menaxhimit të mirë me transparencë dhe llogaridhënie të shtuar në menaxhimin e financave publike²⁵.

Ciklet e fundit të matjes, tregojnë se Maqedonia e Veriut ka përparuar më së shumti për sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike në fushën e transparencës dhe hapjes. Është shteti i parë në rajon që vendosi ta rregullojë politikën e hapjes përmes një dokumenti të veçantë, Strategjisë për transparencë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut²⁶ qysh në vitin 2019 dhe këtë praktikë e ka vazhduar edhe në vitin 2022. Me mbështetje eksperte dhe financiare nga Fondacioni “Metamorfozis”²⁷, Qeveria po përgatit një Strategji të re të Transparencës së Qeverisë për periudhën 2023-2026²⁸. Gjithashtu, në fillim të vitit 2023, Qeveria miratoi një konkluzion që poseduesit e informacionit, të mbuluar nga Udhëzimet për përmirësimin

25 Programi për punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022–2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Fq. 8, marrë nga: <https://cutt.ly/WKKSjQK>.

26 Strategjia e Transparencës së Qeverisë (2019 – 2021) me plan veprimi, në dispozicion në <https://vlada.mk/nacionalni-strategji>


27 Fondacioni Metamorfozis: https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/metamorfozis-so-poddrshka-na-procesot-za-kreiranje-na-strategjia-na-transparentnost-na-vladata-ke-pridonese-vo-unapreduvanje-na-procesot-na-transparentnost-na-vladata-i-instituciite/

28 Seanca e 121-të e Qeverisë, 24.1.2023, Informata për nevojën e hartimit të Strategjisë për Transparencë me Plan Veprimi (2023 – 2026) të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në <https://vlada.mk/vladani-sednici?page=1>

e transparencës së institucioneve në sektorin publik²⁹, t'i publikojnë të gjitha informatat e sistemuara sipas fushave për të cilat paraprakisht është konstatuar janë informacioni më i kërkuar nga qytetarët dhe e ngarkoi Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik të informojë për zbatimin e detyrimeve nga konkluzioni. Gjithashtu, presioni dhe kushtëzimi i vendit nga procesi i anëtarësimit në BE kontribuoi, nëpërmjet reformës në administratën publike, që një nga prioritetet të jetë 'përgjegjësia, llogaridhënia dhe transparenca'³⁰. Në Maqedoninë e Veriut u miratua Plani i Politikave për Qeverisje të Mirë³¹ për vitin 2023, me 24 synime të shoqëruara me një sërë aktivitetesh për t'u përbushur.

Marrë në tërësi, mbajtja e vendit të parë në përbushjen e treguesve të hapjes është rezultat i përgatitjes dhe miratimit të akteve të përmendura, por edhe të një sërë aktesh e mjetesh të tjera ligjore³² të cilat drejtpërdrejt dhe tërthorazi e rregullojnë hapjen dhe transparencën e pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut.

Pushteti ekzekutiv – hapja sipas nënkategorive



Analiza e bazës së të dhënave të Indeksit të Hapjes, e ndarë në katër nënkategori (transparenca, integriteti, qasshmëria dhe efikasiteti) tregon se rezultati total i pushtetit ekzekutiv arrin **vlërësimin më të lartë prej 60,44% të përbushjes së treguesve të transparencës** (si edhe vitin e kaluar), ndërsa **vlërësim më të ulët për efikasitetin prej 52,82%**. Treguesit e efikasiteti - e shqyrtojnë përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit - duke përdorur pika/tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit. Prandaj, rekomandimet që i thekson ky dokument, në fakt vënë në dukje se është nevojshme të zbatohet roli i

29 Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik në bashkëpunim me Kabinetin e Zëvendëskryeminstres Përgjegjëse për Politikën e Qeverisjes së Mirë dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve kanë përgatitur Udhëzues për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik, në dispozicion këtu: <https://aspi.mk/%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8/%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b7%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b8%d1%80%d0%b0%d0%bd%d0%be-%d1%83%d0%bf%d0%b0%d1%82%d1%81%d1%82%d0%b2%d0%be%d1%82%d0%be-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%be%d0%b1%d1%80%d1%83%d0%b2/>


30 Reforma e Administratës Publike, në dispozicion në: <https://mioa.gov.mk/?q=mk/node/2103>

31 Plani i Politikave për Qeverisje të Mirë, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/plan_2023_public_final_mk.pdf

32 Strategjia për Reformën e Administratës Publike (2023 – 2030), Programi për Reforma në Menaxhimin e Financave Publike 2022 – 2025, Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (Gazeta Zyrtare nr: 101/2019), Strategjia e të Dhënave të Hapura 2018 – 2020, Portali <https://data.gov.mk/>, Politika për 21 dokumente e cila i detyron të gjitha ministritë të publikojnë një sërë dokumentesh në ueb-faqet e tyre si mjet për llogaridhënie dhe transparenca para publikut, Ligji për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori i Publik etj.

Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të politikave ekzistuese. Gjithashtu, rekomandohet që institucionet të përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit, si dhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.

Hapja e institucioneve në nënkategori



Një përfundimi tjetër i përgjithshëm që rezulton nga institucionet e monitoruara në Indeksin e Hapjes, dhe i cili përsëritet disa vite me radhë, është ekzistenca e një korrelacioni të drejtpërdrejtë midis hierarkisë së institucioneve dhe rënies së vlerësimit të tyre. Edhe pse organet ekzekutive kanë shënuar progres këtë vit në krahasim me matjen e vitit të kaluar, sërish kanë rezultatin më të ulët sipas Indeksit, gjegjësisht 54,04% përmbushje të treguesve, krahasuar me mesataren e ministrive që përmbushin 61,58%, dhe Qeveria e cila ka rezultatin më të lartë total, përkatësisht 79,14% përmbushje të treguesve. Kjo do të thotë se angazhimi dhe aplikimi i standardeve të hapjes janë në nivele të ndryshme të struktura të ndryshme të pushtetit ekzekutiv dhe për këtë arsye koncepti i hapjes duhet të trajtohet në mënyrë sistematike. Është e evidente se sa më e lartë të jetë hierarkia e institucionit, aq më shumë ka gjasa që ai të investojë mjete për dukshmërinë e punës së tij dhe për marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, duhet theksuar se ka ende institucione të pushtetit qendror që nuk i respektojnë udhëzimet e Qeverisë për vitin 2021 për publikimin e 22 informatave të detyrueshme në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, dhe as nuk kanë vepruar sipas konkluzionit të Qeverisë që t'i publikojnë të gjitha informacionet e sistemuara sipas fushave³³ në përputhje me Udhëzimet për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik. Duke pasur parasysh se shumica e treguesve të Indeksit të Hapjes i referohen faqeve të internetit si burim informacioni, ky aspekt reflektohet ndjeshëm në rezultatin e tyre të përgjithshëm dhe për rrjedhojë disa nga institucionet janë nën mesataren e përmbushjes së treguesve.

Të dhënat e mëposhtme ofrojnë një pamje të rezultateve dhe të arritjeve të institucioneve për secilin parim veç e veç, edhe atë për **respektimin e transparencës, qasshmërisë, efikasitetit dhe integritetit.**

33 Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik në bashkëpunim me Kabinetin e Zëvendëskryeminstres Përgjegjëse për Politikën e Qeverisjes së Mirë dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve kanë përgatitur Udhëzues për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik, në dispozicion këtu: <https://aspi.mk/%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8/%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b7%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b8%d1%80%d0%b0%d0%bd%d0%be-%d1%83%d0%bf%d0%b0%d1%82%d1%81%d1%82%d0%b2%d0%be-%d1%82%d0%be-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be-%d0%b4%d0%be-%d0%b1%d1%80%d1%83%d0%b2/>

Indeksi ofron gjithashtu një analizë të thellë individualisht sipas institucioneve, përkatësisht: E vlerëson disponueshmërinë publike të informacionit organizativ, buxhetit dhe procedurave për furnizimet publike (**transparenca**); vlerëson shkallën në të cilën e drejta e qasjes në informacion garantohet me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultim gjatë proceseve të hartimit të politikave (**qasshmëria**); e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimi – duke përdorur pikat/indiktorët kyç gjatë planifikimit dhe raportimit strategjik (**efikasiteti**); dhe e vlerëson praninë e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit, rregullimin e lobimit, si dhe disponueshmërinë e Kodit të sjelljes etike që e drejton dhe e sanksionon sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe të administratës publike (**integriteti**). Një vlerë e shtuar e Indeksit të Hapjes është se përmes analizës së të gjitha parimeve, është vlerësuar edhe puna përmes praktikës dhe përkushtimit ndaj konceptit të **të dhënave të hapura**. Rezultatet janë marrë veçmas për çdo nivel të qeverisjes (qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive), duke nxjerrë në pah shembujt e mirë që dallohen në secilin grup.


Top 3 institucionet e hapura në Maqedoninë e Veriut



Nga matja e gjithsej 36 institucioneve, **Ministria e Mbrojtjes (89,72%)** është institucioni lider në përmbushjen e treguesve të hapjes, e më pas vijojnë **Qeveria (79,14 %)** dhe **Ministria e Punëve të Brendshme (78,9 %)**. Më pas në renditje vijnë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (75,35 %) dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (72,56 %), duke zënë kështu 5 vendet e para për sa i përket përmbushjes së treguesve.

Në Ministrinë e Financave (63,6 %) dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale (48,49 %), në tre matjet e fundit është vërejtur trend në rënie i përmbushjes së treguesve.

Tendencë në rënie e hapjes



Lista e renditjes së institucioneve me shkallën e përbushjes së treguesve të hapjes


RENDITJA	Qeveria dhe ministrinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut	% e përbushjes së treguesve të hapjes	RENDITJA	Organet ekzekutive	% e përbushjes së treguesve të hapjes
1	Ministria e Mbrojtjes	89,72 %	1	Byroja për Siguri Publike	71,7 %
2	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	79,14 %	2	Byroja e Zhvillimit Rajonal	67,17 %
3	Ministria e Punëve të Brendshme	78,9 %	3	Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizimit	65,16 %
4	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	75,35 %	4	Inspektorati Shtetëror i Tregut	63,33 %
5	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	72,56 %	5	Inspektorati Shtetëror i Arsimit	62,87 %
6	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	68,08 %	6	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor	58,8 %
7	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	66,96 %	7	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor	57,9 %
8	Ministria e Financave	63,6 %	8	Enti Shtetëror i Statistikave	57,44 %
9	Ministria e Punëve të Jashtme	61,92 %	9	Byroja për Furnizime Publike	54,28 %
NËN MESATARËN PREJ 61,58 % TË MINISTRIVË			NËN MESATARËN prej 54,04 % TË ORGANEVE EKZEKUTIVE		
10	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave	61,18 %	10	Agjencia e Emigracionit e Republikës së Maqedonisë së Veriut	51,11 %
11	Ministria e Shëndetësisë	59,87 %	11	Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	50,68 %
12	Ministria e Ekonomisë	58,75 %	11	Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik	50,66 %
13	Ministria e Drejtësisë	58 %	13	Byroja për Ekspertizë Ligjore	48,85 %
14	Ministria e Kulturës	50,54 %	14	Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	48,39 %
15	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	48,49 %	15	Inspektorati Shtetëror i Pylltarisë dhe Gjuetisë	47,94 %
16	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	43,82 %	16	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve	47,49 %
17	Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhëniet me Bashkësitë	27,59 %	17	Drejtoria e të Ardhurave Publike	47,04 %
			18	Sekretariati për Çështje Evropiane	38,89 %
			19	Drejtoria e Policisë Financiare	37,08 %

3.3.1. Transparenca

Transparenca është një koncept i gjerë që lidhet me disponueshmërinë e informacionit dhe me qasjen dhe përdorshmërinë e informacionit nga qytetarët, gjegjësisht kërkuesit e informacionit. E përcaktuar në këtë mënyrë, ajo përfshin transparencën aktive, gjegjësisht publikimin proaktiv të informacionit nga institucionet publike dhe transparencën pasive (reaktive), ku dhënia e informacionit inicohet nga kërkuesi i informacionit (nëpërmjet përdorimit të së drejtës për qasje në informacion). Në thelb, transparenca ndikon në uljen e korrupsionit, rritjen e pjesëmarrjes së palëve të interesuara në vendimmarrje, si dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve, gjegjësisht shkalla e transparencës, ndër të tjera, ndikon në qeverisjen e mirë.

Nëpërmjet treguesve me të cilët vlerësohet disponueshmëria publike e informacionit të organizatës, pjesëmarrja e palëve të interesuara në krijimin e buxhetit dhe transparenca në shpenzimin e buxhetit nga pushteti ekzekutiv, si dhe transparenca në procedurat e furnizimeve publike, është vlerësuar pushteti ekzekutiv (qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) vlerësohet **me vlerësimin më të lartë për treguesit e transparencës me përmbushje prej 60.44%**. Në matjen e këtij viti, transparenca është rritur për 6% për sa i përket përmbushjes së treguesve. Të analizuara individualisht, organet ekzekutive janë në fund të shkallës për sa i përket përmbushjes së treguesve të transparencës me 55,26%, pastaj ministritë me 58,83% dhe në vend më të larta është qeveria me 67,76% përmbushje të treguesve të transparencës.

TRANSPARENCA – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Duke qenë se faqet e internetit janë, në mënyrë legjitime, burimi kryesor i informacionit për punën e institucioneve, dhe në të njëjtën kohë ato janë një mjet për qasjen më të shpejtë, më të lehtë dhe më të sigurt në informacione, duhet theksuar ka ende institucione të pushtetit qendror që nuk i respektojnë udhëzimet e Qeverisë për vitin 2021 për publikimin e 22 informatave të detyrueshme në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, dhe as nuk kanë vepruar sipas konkluzionit të

Qeverisë që t'i publikojnë të gjitha informacionet e sistemuara sipas fushave³⁴ në përputhje me Udhëzimet për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik. Duke pasur parasysh se shumica e treguesve të Indeksit të Hapjes i referohen faqeve të internetit si burim informacioni, ky aspekt reflektohet ndjeshëm në rezultatin e tyre të përgjithshëm dhe për rrjedhojë disa nga institucionet janë nën mesataren e përbushjes së treguesve.

3.3.1.1. Informacioni për organizatën

Institucionet janë transparente kur u mundësojnë qytetarëve, pra palëve të interesuara, të shohin dhe kuptojnë se si funksionojnë dhe funksionojnë. Për të arritur transparencë, organizata duhet të sigurojë informacion në lidhje me kompetencat, aktivitetet dhe punën e tij që është i saktë, i plotë dhe i disponueshëm në kohën e duhur. Faqja e internetit e Qeverisë përditësohet rregullisht dhe ofron informacione dhe të dhëna të rëndësishme për kompetencat që i ushtron, informacion bazë të kontaktit, të dhëna për funksionarët (biografite), listat e punonjësve me pozicione, e-mail dhe telefon, ligjet që kanë të bëjnë me kompetencat, rregulloret për organizimin e brendshëm, për sistemin e vendeve të punës, si dhe organogram për organizimin e brendshëm. Ueb-faqja e Qeverisë ofron detaje kontakti për nëpunësit shtetërorë dhe njësitë në Sekretariatit e Përgjithshëm, por në këtë matje është vërejtur se të dhënat për rrogat e funksionarëve qeveritarë nuk janë përditësuar.³⁵ Seancat e Qeverisë kur shpallen, shoqërohen me agjenda të publikuara të seancave, por gjatë kësaj matjeje është vërejtur shpallja me vonesë e seancave, e me këtë edhe publikimi i agjendave dhe procesverbaleve të mbledhjeve dhe komunikatave për mediat³⁶. Edhe këtë vit mbetet rekomandimi për Qeverinë për përmirësimin e transparencës, duke i ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare, që të publikohen dokumentet që shqyrtohen dhe diskutohen në seancat e Qeverisë, si dhe publikimi i transkripteve të mbledhjeve. Qeveria duhet të konsiderojë krijimin e një kanali që do t'i mundësonte publikut të ndjekë drejtpërdrejt vendimet për politikën që ndikojnë drejtpërdrejt mbi ta, duke ndjekur shembullin e Kuvendit.

Sa i përket cilësisë së ueb-faqeve të ministrive, të gjitha vlerësohen pozitivisht për rregullsinë e përditësimit të faqeve të tyre, ndërsa Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive dhe Ministria e Financave veçohen si shembull negativ i mosfunksionimit të kërkuesve në faqet e tyre të internetit. Numri i faqeve zyrtare të internetit midis organeve ekzekutive me opsione funksionale të kërkimit është 16 nga 19 organe, domethënë, vetëm 3 nuk kanë opsione funksionale të kërkimit, edhe atë: Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor.

Ministritë i publikojnë biografitë e ministrave, ndërsa në rastin organeve ekzekutive, 20% e institucioneve të vlerësuara nuk i publikojnë biografitë e drejtorëve të tyre. Të gjitha ministritë i kanë publikuar organogramet e ministrisë, ndërsa shumica kanë dhënë një përshkrim të kompetencave të ministrisë, gjë që nuk është rasti me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, të cilat kanë nuk ka publikuar përshkrimin e kompetencave të ministrisë. Të

34 Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik në bashkëpunim me Kabinetin e Zëvendëskryeminstres Përgjegjëse për Politikën e Qeverisjes së Mirë dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve kanë përgatitur Udhëzues për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik, në dispozicion këtu: <https://aspi.mk/%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8/%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b7%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b8%d1%80%d0%b0%d0%bd%d0%be-%d1%83%d0%bf%d0%b0%d1%82%d1%81%d1%82%d0%b2%d0%be-%d1%82%d0%be-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%be%d0%b1%d1%80%d1%83%d0%b2/>

35 Rrogat e presidentit dhe të ministrave në qeveri. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/plati>.

36 Njoftimi i fundit për seancë të Qeverisë është para 1 muaji (22.8.2023); qasur më 21.9.2023. <https://vlada.mk/vladini-sednici>

gjitha organet ekzekutive, në kuadër të mundësive ligjore³⁷, i kanë publikuar organogramet e institucioneve. Informacione të përditësuara të kontaktit për nëpunësit shtetërorë mungojnë vetëm te Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive dhe në 1/4 e organeve ekzekutive.

Gjysma e ministrive kanë publikuar programe vjetore të punës, mirëpo e lartë është përqindja prej 60% (7 nga 16) e atyre që nuk kanë publikuar raporte vjetore për punën e tyre. Rezultati është gjithashtu i dobët kur bëhet fjalë për publikimin e programeve vjetore të punës nga organet ekzekutive, ku vetëm 36% e organeve ekzekutive i kanë publikuar ato, ndërsa madje 80% e organeve ekzekutive nuk publikojnë raporte vjetore për zbatimin e këtyre programeve. Sa i përket raporteve tremujore apo gjashtëmujore, ministrinë nuk i publikojnë ato, përveç Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mbrojtjes që publikojnë rregullisht raporte; ndërsa tek organet ekzekutive 1/3 e tyre shquhen si shembull i mirë sepse publikojnë raporte tremujore ose gjashtëmujore.

Në ueb-faqet e 13 ministrive mungojnë informata për rrogat e ministrave, sikurse edhe në matjen e vitit të kaluar, megjithëse është e paqartë pse kjo nuk është bërë kur të dhënat janë publike në ueb-faqen e Qeverisë, të cilat nuk janë përditësuar³⁸. Në faqet individuale të internetit të ministrive, janë publikuar rrogat e ministrave për punë të brendshme, të mbrojtjes dhe të vetëqeverisjes lokale. Nga organet ekzekutive, vetëm një e ka publikuar këtë të dhënë për shumën e rrogave të drejtorëve (Byroja e Sigurisë Publike). Dy ministri (Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme) kanë publikuar strategji komunikimi (PR). Krahasuar me matjen e mëparshme, ekziston një përshtypje e përgjithshme se shumica e institucioneve e kanë ruajtur nivelin e informacionit të publikuar, por pritet që ta përmirësojnë atë.

Kështu, Ministria e Mbrojtjes (78,23 %), Ministria e Shëndetësisë (70,65 %) dhe Ministria e Financave (68,58 %) janë në 3 vendet e para të renditjes për sa i përket përmbushjes së treguesve të transparencës. Ndër organet ekzekutive, përmbushjen më të lartë të treguesve të transparencës e kanë arritur Inspektorati Shtetëror i Tregut (69,18%), Byroja e Zhvillimit Rajonal (68,82%) dhe Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor (67,65%).

3.3.1.2. Buxheti

Duke qenë se transparenca në planifikimin dhe zbatimin e financave publike është një element kyç për qeverisjen e mirë, në këtë Indeks të Hapjes, transparenca buxhetore e qeverisë qendrore është matur përmes një sërë treguesish. Konkretisht, transparenca buxhetore është domethënëse nga aspekti i informimit të tatimpaguesve, përkatësisht qytetarëve, për qëllimin për të cilin institucionet i planifikojnë dhe i shpenzojnë mjetet e tatimpaguesve. Gjithashtu, është matur edhe shpalosja në kohë dhe sistematike e informacionit përkatës fiskal, sepse kontribuon në uljen e korrupsionit, si dhe në sigurimin e pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në proceset buxhetore.

Për të rritur transparencën dhe për të sjellë informacionin për shpenzimet e buxhetit të shtetit më pranë qytetarëve dhe të gjithë të interesuarve, si dhe për përdorimin e të dhënave për qëllime analitike, shkencore dhe kërkimore, në vitin 2019 Ministria e Financave hapi të dhënat për publikun përmes portalit “Financat e Hapura”, i cili i mundësoi publikut të ketë qasje në të dhënat për realizimin e transaksioneve të të gjithë përdoruesve buxhetorë të buxhetit të shtetit me të cilët disponon thesari.

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është publikuar në faqen e Qeverisë. Në Ministrinë e Financave, si ministri kompetente, buxheti i shtetit publikohet në format të hapur, por edhe në faqen e internetit. <http://budget.mk>

37 Aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë e Policisë Financiare (pjesë përbërëse e së cilës është edhe organogrami) klasifikohen me shkallë të përshtatshme klasifikimi në përputhje me Ligjin për Informatat e Klasifikuara, dhe për këtë arsye nuk mund t'i nënshtrohen qasjes së lirë.

38 Rrogat e presidentit dhe të ministrave në qeveri. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/plati>.

finance.gov.mk, e cila u krijua në vitin 2017, dhe këtë vit buxheti u publikua në mënyrë të kuptueshme për qytetarët në formën e Buxhetit qytetar, i cili e shpërndan buxhetin e shtetit sipas klasifikimit ekonomik, pastaj sipas fushës funksionale, sipas përdoruesve buxhetorë, si dhe ofron paraqitje të iniciativave buxhetore të ndjeshme gjinore. Praktika e publikimit të Buxhetit qytetar është ruajtur edhe nga Qeveria³⁹. Ministria e Financave e publikon edhe gjendjen e borxhit publik⁴⁰, ndër të tjera. Janë publikuar edhe dokumentet për reformën aktuale dhe atë të planifikuar në menaxhimin e financave publike. Për sa i përket raporteve financiare, edhe ato publikohen periodikisht në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Ministrinë e tjera nuk e publikojnë këtë informacion, përveç Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive nuk i publikuan informacionet lidhur me buxhetin, gjegjësisht planin financiar. Mbetet rekomandimi nga viti i kaluar që të përmirësohen konsultimet me publikun, të futen konsultimet publike gjatë planifikimit të buxhetit, si dhe të publikohen informatat për shpenzimin e rezervave buxhetore.

Nga organet ekzekutive, 58% i publikojnë rregullisht planet vjetore financiare, sa i përket raportimit, 68% prej tyre i publikojnë llogaritë përfundimtare, ndërsa vetëm dy prej tyre, Byroja për Zhvillimin Rajonal⁴¹ dhe Byroja e Sigurisë Publike⁴², publikojnë raporte financiare periodike në faqen e tyre të internetit.

3.3.1.3. Procedurat për furnizime publike

Furnizimet publike renditen si të parat nga disa fusha horizontale prioritare me rrezik të lartë korrupsioni në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit⁴³ 2021 – 2025. Sistemi i furnizimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i zhvilluar mirë⁴⁴, me një kornizë ligjore dhe institucionale të vendosur, e cila duhet të avancohet në përputhje me Planin për Politika të Qeverisjes së Mirë⁴⁵ për të krijuar një sistem me kontroll më të madh të tenderëve për furnizime publike, duke përmirësuar formën e specifikimeve, që do të shmangë keqpërdorimin e tyre.

Byroja e Furnizimeve Publike është i vetmi institucion përgjegjës për publikimin e dokumenteve në lidhje me procedurat për furnizime publike përmes sistemit elektronik për furnizime publike. Në Planin për Politika të Qeverisjes së Mirë është dhënë rekomandimi për publikimin e informatave themelore për furnizime publike në faqet e internetit të institucioneve të ndryshme, e cila nuk zbatohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë. Një shembull pozitiv se si bëhet kjo është Ministria e Mbrojtjes⁴⁶. Prandaj, në Propozim-Strategjinë për Transparencë të Qeverisë (2023-2026), në kapitullin “Transparenca aktive e qeverisë dhe organeve të tjera të pushtetit ekzekutiv”, janë përcaktuar drejtimit strategjike për

39 Buxheti qytetar 2022. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/node/27005>.

40 Ministria e Financave; Borxhi publik, në dispozicion në <https://javendolg.finance.gov.mk/>

41 Në dispozicion në <https://brr.gov.mk/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d1%84%d0%b8%d0%bd%d0%b0%d0%bd%d1%81%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd%d0%be%d0%b2%d0%b8-%d0%bf%d0%be-%d0%ba%d0%b2%d0%b0%d1%80%d1%82%d0%b0/>

42 Në dispozicion në [Republika e Maqedonisë së Veriut - Ministria e Punëve të Brendshme \(mvr.gov.mk\)](https://mvr.gov.mk)

43 Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit është miratuar nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në dhjetor të vitit 2020, dhe është miratuar Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në prill të vitit 2021.

44 Qëllimet, masat dhe aktivitetet në fushën e furnizimeve publike janë përfshirë në Programin për Reforma në Menaxhimin e Financave Publike (2018-2021). Kurse, në fillim të vitit 2021, në “Planin për luftën kundër korrupsionit – Veprimi 21”, Qeveria, me sugjerim të shoqërisë civile, përfshiu disa masa kundër korrupsionit në fushën e furnizimeve publike, me të cilat i obligoi të gjitha organet kontraktuese të zhvillojnë procedura të brendshme për zbatimin e procedurave për furnizime publike dhe për zbatimin e kontratave.

45 Plani për Politika të Qeverisjes së Mirë, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/ggpp2022_final_mk.pdf për vitin 2022 dhe 2023, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/plan_2023_public_final_mk.pdf

46 Në dispozicion në <https://mod.gov.mk/%D0%BE%D0%B1%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%BE%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D1%81%D0%B8>

lidhjen e të dhënave për furnizimet publike të vendosura në faqet e internetit të ministrive dhe të organeve të tjera ekzekutive dhe ato të Sistemit Elektronik për Furnizime Publike, me qëllim që të korrespondojnë të dhënat.

Edhe këtë vit mbetet konstatimi i përgjithshëm për problemet dhe shkeljet e shpeshta⁴⁷ në procedurat për furnizime publike që duhet të tejkalohen duke zbatuar kornizën ligjore dhe Strategjinë e miratuar për Avancimin e Sistemit të Furnizime Publike⁴⁸ në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022 – 2026) dhe Planin e Veprimit, si dhe të merren masa konkrete në standardizimin e furnizime publike⁴⁹.

Indeksi i hapjes, nëpërmjet një sërë treguesish në këtë fushë, vlerësimin për arritjet e pushtetit qendror e formon nëpërmjet planeve, thirrjeve, vendimeve, kontratave dhe anekseve për furnizimet publike të publikuara në faqet e internetit të institucioneve, gjegjësisht që janë të disponueshme publikisht.

Qeveria plotëson 12 nga 13 treguesit e kësaj nënkategorie, me dobësi të vetme se nuk janë publikuar ende pronarët e vërtetë të ofertuesve dhe të kompanive që kanë lidhur kontratë me institucionet në procedurën e furnizimit publik. Qeveria vlerësohet pozitivisht për publikimin e planeve, thirrjeve, vendimeve dhe kontratave me anekse për furnizimet publike në faqen e saj të internetit. Edhe qeveria ka praktikë pozitive dhe e publikon raportin e fundit vjetor për të gjitha furnizimet publike.

Disa vite me radhë, për të përmirësuar procedurën për furnizime publik dhe për të zvogëluar mundësinë e keqpërdorimit të mjeteve, është dhënë rekomandimi, i cili përsëritet edhe këtë vit, që nëpunësit që kryejnë furnizime publike të jenë të obliguar të plotësojnë një deklaratë për konflikt të interesit dhe të dorëzojnë fletë anketuese për gjendjen e pasurisë. Gjithashtu, ripërsëritet rekomandimi për nevojën e shpalljes publike të pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur furnizime publike në sistemin elektronik për furnizime publike, gjë që do të parandalojë korrupsionin, do të reduktojë ndjeshëm keqpërdorimin me tenderët e furnizimeve publike dhe do të shërbejë për të garantuar konkurrencë të ndershme ndërmjet ofertuesve, dhe e cila si masë është parashikuar edhe në Planin e pestë Kombëtar të Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur (2021 – 2023)⁵⁰.

Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të shkallës në të cilën ministrinë dhe organet ekzekutive i përmbushin treguesit që e vlerësojnë transparencën në procedurat për furnizime publike. Ka një përmirësim të përgjithshëm në performancën e ministrive dhe veçanërisht të organeve ekzekutive krahasuar me vitin e kaluar. Për herë të parë është matur përmbushje 100% e një treguesi në lidhje me publikimin e planeve për furnizime publike nga ministrinë në faqet e tyre të internetit. Sa i përket publikimit të raporteve vjetore nga ana e organeve ekzekutive, këtë vit, në të dy nivelet, ka një rënie të numrit të institucioneve që publikojnë raporte vjetore për furnizimet publike. Krahasuar me vitin e kaluar, matja e sivjetshme ka treguar se Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit me Ujërat dhe Ministria e Drejtësisë. nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve të Indeksit të Hapjes, për sa i përket raporteve vjetore për furnizimet publike. Edhe pse ky nuk është detyrim ligjor, është një praktikë e mirë ndërkombëtare dhe institucionet duhet të vazhdojnë me përkushtimin për ta vendosur atë si praktikë. Andaj, edhe këtë vit mbetet rekomandimi që institucionet të përgatisin një raport përmbledhës vjetor për të gjitha furnizimet publike për vitin paraparak.

47 Raporti në hije për furnizimet publike 2021, Qendra për Komunikime Qytetare. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/vKKGy53>

48 Strategjia për Avancimin e Sistemit për Furnizimet Publike 2022– 2026. Byroja për Furnizime Publike. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/bKKGhWJ>

49 Gërkovska: Na duhet një sistem për furnizime publike dhe standardizimin që të mos ketë keqpërdorime. Telma. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/IKKGchs>. Plani për Politika për Qeverisje të Mirë 2023 https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/plan_2023_public_final_mk.pdf

50 Plani Kombëtar i Veprimit për PQH (2021– 2023). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/dKKDos0>

% e përmbushjes së treguesve nga ministritë dhe organet ekzekutive, të cilët matin progresin në transparencën e procedurave të furnizimeve publike, veçmas sipas treguesve me një krahasim mes viteve 2022 dhe 2021

Treguesit	Ministritë		Organet ekzekutive	
	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2022
A janë postuar në faqen e internetit? planet për furnizime publike?	94 %	100 %	60 %	84 %
A janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit thirrjet për furnizimet publike?	81 %	87,5 %	60 %	74 %
A janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit vendimet për furnizimet publike?	81 %	87,5 %	57 %	68 %
A janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit kontratat për furnizimet publike?	81 %	87,5 %	39 %	79 %
A janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit anekset e kontratave për furnizimet publike?	56 %	87,5 %	60 %	74 %
A është i disponueshëm në faqen e internetit raporti i fundit vjetor për të gjitha furnizimet publike?	75 %	68,75 %	24 %	16 %


3.2.2. Qasshmëria

Indeksi i hapjes në nënkategorinë e qasshmërisë, shkallën e hapjes e mat përmes treguesve që e vlerësojnë shkallën në të cilën garantohet e drejta për qasje në informacionin sipas ligjit dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për angazhimin dhe konsultimin me publikun në proceset e hartimit të politikave. Institucionet e pushtetit ekzekutiv (duke përfshirë Qeverinë, ministritë dhe organet ekzekutive) kanë një vlerësim mesatar të arritjes në nënkategorinë e qasshmërisë prej 52,94% përmbushje të treguesve. **Për vlerësimin mesatar ndikon përmbushja e ulët e treguesve të qasshmërisë nga ministritë (41,54 %) dhe nga organet ekzekutive (41,96 %), të cilët janë nën vlerësimin e përgjithshëm mesatar në nënkategorinë e qasshmërisë. Për dallim prej tyre, qeveria plotëson 75.31% të treguesve të qasshmërisë.** Sipas përfshirjes së nënkategorisë së qasshmërisë, Qeveria vlerësohet kryesisht për cilësinë e kornizës ligjore që e garanton të drejtën e qasjes në informacion, si dhe praktikën e saj, ndërsa rezultatet e ministrive dhe të organeve ekzekutive mbështeten tërësisht në masën në të cilën ata i praktikojnë dispozitat ligjore dhe standardet

51 Edhe pse institucionet kanë bërë një hap pozitiv duke integruar kryesisht pjesë të portalit për furnizime publike në faqet e tyre të internetit, duhet të publikohen raporte vjetore të veçanta për të gjitha furnizimet publike në një dokument të veçantë në format të hapur.

ndërkombëtare të monitoruara përmes Indeksit të Hapjes. Prandaj, shumica e rekomandimeve që i theksojnë ky dokument kërkojnë zbatim efikas të politikave ekzistuese nga ministrinë dhe organet ekzekutive.

QASSHMËRIA – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Individualisht, në mesin e ministrive, Ministria e Mbrojtjes (63,85 %), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (56,924 %) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (56,928 %) janë në tre vendet e para të renditjes për sa i përket përmbushjes së treguesve të qasshmërisë. Ndër organet ekzekutive, përmbushjen më të lartë të treguesve të qasshmërisë e kanë arritur Byroja për Siguri Publike (62,67%), Agjencia për Emigracion e Republikës së Maqedonisë së Veriut (54,67%) dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (54,67%).

3.3.2.1. Qasja në informacion

Qasja në informacion është një komponent kyç i qeverisë transparente dhe të përgjegjshme. Qëllimi i qasjes në informacion është t'u mundësojë qytetarëve të shohin se si funksionon qeveria, gjegjësisht të jenë në gjendje të zbulojnë korrupsionin ose të zbulojnë të meta në krijimin e politikave. Në këtë kuptim, informacioni që krijohet dhe me të cilin disponojnë autoritetet publike i përket publikut. Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik⁵² parashikon detyrimin për poseduesit e informatave për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje në informatat me karakter publik (qasje reaktive), por përmban edhe dispozita për publikimin proaktiv të informatave, gjegjësisht publikimin e pavarur të informatave, që njihet si transparencë aktive. Zbatimi i publikimit aktiv të informatave është forcuar me miratimin e një konkluzioni nga qeveria që poseduesit e informatave, të përfshira me Udhëzimet për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik, t'i publikojnë të gjithë informatat e sistemuara sipas fushave për të cilat paraprakisht është konstatuar se janë informata më shpesh të kërkuara nga qytetarët.

52 Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 101/2019 e datës 22.05.2019 Të rehat nga viti 2019 që janë futur në ligj: u zgjerua lista e poseduesve të informatave; u përcaktua një listë më e gjerë e informatave që institucionet janë të detyruara t'i publikojnë në mënyrë proaktive; është përcaktuar interesi publik; afati për t'iu përgjigjur kërkesës është shkurtuar në 20 ditë; lista e përjashtimeve nga qasja e lirë u shkurtua; dhe u përcaktuan kompetencat e zgjeruara të organit të shkallës së dytë me mundësinë e zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, të gjitha këto me qëllim të sigurimit të publicitetit dhe hapjes së institucioneve, me rezultatin - qytetar i informuar.

Indeksi i hapjes përmes faqeve të internetit vlerëson institucionet e pushtetit qendror (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) nëse kanë informacion të përditësuar për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacion; nëse ata publikojnë kërkesat tashmë të përgjigjura për qasje të lirë; si dhe nëse faqja e internetit ka një seksion të veçantë të dedikuar për ushtrimin e së drejtës për qasje në informata, ku gjenden informatat relevante; a kanë publikuar një listë të përditësuar të informatave etj. Ueb-faqja e qeverisë i plotëson plotësisht kriteret për të ushtruar të drejtën e qasjes së lirë, mirëpo si dobësi përsëri është evidentuar fakti se nuk i publikon përgjigjet që i përgatit për kërkesat për qasje të lirë në informata. Kjo praktikë është vërejtur në disa ministri, edhe atë të: Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Kulturës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Nga organet ekzekutive, kjo praktikohet nga: Byroja e Zhvillimit Rajonal, Enti Shtetëror i Statistikave, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Byroja e Sigurisë Publike. Mund të konstatohet se ka një përmirësim në praktikë, krahasuar me vitin e kaluar, për sa i përket publikimit të përgjigjeve me të cilat kanë ofruar qasje në informata pas kërkesës së parashtruar në faqet e internetit.

Duke marrë parasysh tendencat dhe proceset e reja të digjitalizimit që po ndodhin në botë, e të cilat po imponohen si domosdoshmëri edhe në vendin tonë, pritjet që në një të ardhme të afërt t'i kushtohet gjithnjë e më shumë vëmendje transparencës aktive, e cila duhet ta zvogëlojë ndjeshëm numrin e kërkesave të parashtruara në letër për qasje të lirë. Prandaj, do të duhet të ndiqen edhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me kohën e pritjes për një përgjigje në lidhje me kërkesën e parashtruar në letër për qasje të lirë, e cila varion nga 7 deri në 15 ditë, dhe do të jetë nevojshme të ndërhyhet tek ne sërish të afati, edhe atë koha e pritjes të reduktohet nga 20 ditë në maksimum 15 ditë. Për ta vlerësuar kohën e pritjes pas kërkesës së parashtruar tek institucionet, "Metamorfozis" gjatë monitorimit të hapjes së institucioneve, dërgoi nga një kërkesë për qasje në informata te 36 institucione, nga të cilat 27 institucione (75%) u përgjigjën në kohë, brenda afatit ligjor. Ndër institucionet që janë përgjigjur pas afatit ligjor janë dy ministri, edhe atë: Ministria e Kulturës dhe Ministria e Shëndetësisë dhe tre organe ekzekutive: Drejtoria e Policisë Financiare, Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik dhe Sekretariati për Çështjet Evropiane. Ndërsa, nga ana tjetër, katër organe ekzekutive refuzuan në heshtje kërkesën për qasje të lirë, gjegjësisht nuk u përgjigjën fare, edhe atë: Arkivi Shtetëror, Byroja e Ekspertizës Mjeko-Ligjore, Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Gjuetisë dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut.

Të gjitha ministritë (93,75%), përveç Ministrisë për Sisteme Politike dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, kanë krijuar një hapësirë (seksion) të veçantë në ueb-faqet e tyre dedikuar procedurës me kërkesat për qasje të lirë në informata. Këtë vit, në tre matjet e fundit është vërejtur një tendencë rënëse për sa i përket trajnimit të zyrtarëve për procedurën për qasje të lirë në informata nga ministritë. Në vitin 2020, 68.75% e ministrive raportuan se i kanë trajnuar nëpunësit për procedurën e qasjes së lirë në informata, në vitin 2021 përqindja e ministrive që trajnuan stafin e tyre ishte 62,5%, ndërsa në vitin 2022 vetëm 50% e ministrive deklaruan se i kishin trajnuar punonjësit e tyre për procedurën për qasje të lirë në informata (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave). Për herë të parë në tre matjet e fundit të hapjes, është vërejtur se Qeveria këtë vit nuk i ka trajnuar nëpunësit e saj për procedurën për qasje të lirë në informata.

Për sa u përket organeve ekzekutive, këtë vit te ato është shënuar përparim për sa i përket krijimit të një seksioni të veçantë në faqet e internetit me procedurën për qasje të lirë në informata. Vetëm Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve nuk ka seksion të veçantë për të drejtën e qasjes së lirë në faqen e saj të internetit. Mirëpo, këtë vit, tek organet ekzekutive është konstatuar një rezultat jashtëzakonisht i dobët për sa i përket kuadrit të trajnuar për procedurën për qasje të lirë. Në fakt, të gjitha organet ekzekutive, përveç njërit, kanë raportuar se nëpunësit e tyre nuk kanë ndjekur trajnime për qasje të lirë.

3.3.2.2. Ndërveprimi me qytetarët

Mundësitë e ofruara dhe roli i mediave digjitale në komunikimin e sotëm janë të padiskutueshme, e veçanërisht në rrjetet sociale në shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit, ndërjegjësimin e publikut për çështjet me interes publik, njohjen e qytetarëve me fushëveprimin e punës së institucioneve dhe hapjen e mundësive që ato të marrin pjesë në proceset e hartimit të politikave, si dhe përdorimin e thjeshtë dhe të shpejtë të shërbimeve. Prandaj, në nënkategorinë e **qasshmërisë** është monitoruar shkalla në të cilën institucionet e lehtësojnë ndërveprimin dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Natyrë dhe përdorimi i shpeshtë i faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera online ("Facebook", "Twitter" e shumë të tjera) i vendos ato në një pozicion qendror për ndërveprim me qytetarët, por monitorimi tregoi mangësi kur bëhet fjalë për përdorimin e kanaleve të komunikimit të shpejtë. Kështu, një kanal të drejtpërdrejtë në faqet e internetit për komunikim online, përmes të cilit qytetarët mund të shprehin shqetësimet, të parashtrojnë parashtresa apo ankesa ose të bëjnë ankesë, në mënyrë identike sikurse edhe vitin e kaluar, kanë Qeveria, vetëm 4 (25%) ministri (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave) dhe 11 organe ekzekutive (57,89 %). Është vërejtur se Qeveria nuk ka një Strategji aktuale të Komunikimit⁵³.

Mediat sociale kontribuojnë në lehtësimin e komunikimit dhe ndërveprimit me publikun, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk mund t'i zëvendësojnë faqet e internetit për sa i përket vëllimit të informacionit që mund të shpërndahet. Rreth 29 nga 36 institucione qendrore të vëzhguara kanë profile zyrtare në "Facebook" dhe 12 prej tyre kanë profile në "Twitter" (d.t.th. "X"). Mbetet konkluzioni nga viti i kaluar se dalëngadalë po braktiset praktika e përdorimit vetëm të profileve personale të funksionarëve si zyrtare në mediat sociale, mirëpo ato janë më të pasura me informata për dallim nga kanalet zyrtare të institucioneve në mediat sociale. Problemi kryesor me profilet personale të funksionarëve është ajo se ato pushojnë së përdoruri si burim informacioni dhe ndërveprimi me institucionet përkatëse sapo të mbarojë mandati i funksionarit, dhe si të tilla ato nuk përmbajnë memorie të gjata të ngjarjeve në institucione.

Duke marrë parasysh se shoqëria civile është (duhet të jetë) partner i barabartë dhe korrigjues i vendimeve të qeverisë, dhe se është i nevojshëm një dialog i vazhdueshëm, transparent dhe plotësisht gjithëpërfshirës me shoqërinë civile, ministrinë janë monitoruar përmes faqeve të tyre të internetit nëse ato kanë publikuar përmbajtje për aktivitete të përbashkëta me shoqërinë civile në 6 muajt e fundit. Është konstatuar se këtë vit gjysma e ministrive, 50%, publikojnë rregullisht përmbajtje të tilla për aktivitete të përbashkëta me shoqërinë civile.

Për sa i përket lehtësimin të shërbimeve publike, qeveria qendrore e plotëson portalin online të shërbimeve elektronike, që është i disponueshëm në www.uslugi.gov.mk. Mirëpo, është konstatuar se nuk ka një bazë të dhënash të unifikuar që do të mundësonte përcaktimin e përqindjes totale të qytetarëve që përdorin e-shërbime⁵⁴. Megjithatë, uslugi.gov.mk është mjet që luan rol kyç në mundësimin e shërbimeve lehtësisht të qasshme për qytetarët, si veçori e qeverisjes së mirë. Edhe pse insistohet që të gjitha e-shërbimet nga institucionet shtetërore të jenë të rrjetëzuara, të vendosura në uslugi.gov.mk, megjithatë, shërbimet e tilla ofrohen edhe në mënyra të tjera. Për shembull, e-shërbimet ofrohen individualisht edhe nga vetë institucionet. Nëpërmjet faqeve bazë të internetit të ministrive, në 80% të tyre ka në dispozicion seksione me lista të të gjitha shërbimeve që ofrohen nga ministria me lidhje (linke) deri te përshkrimi i shërbimit dhe dokumentacioni i nevojshëm. Kjo lloj liste e shërbimeve elektronike të ofruara nga organet e tjera ekzekutive në faqet e tyre të internetit nuk ekziston.

53 Strategjia e Komunikimit e Qeverisë për periudhën 2019/2020. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/komunikaciska-strategija>.

54 Maqedonia e Veriut "Observatori i Agjendës Digjitale", qershor 2022. Fondacioni Metamorfozis, në dispozicion në https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/opservatorija-za-digitalnata-agenda-izveshtaj-za-tekovnata-sostojsba-i-patokaz-za-unapredovanje-na-digitalnata-agenda-vo-severna-makedonija-2022/

3.3.2.3. Konsultimet publike

Pjesëmarrja në kohë dhe thelbësore e qytetarëve në krijimin e politikave është parakusht që një shoqëri demokratike të njihet si transparente dhe llogaridhënëse. Nga njëra anë, nëpërmjet pjesëmarrjes së publikut në proceset e përgatitjes së politikave, mundësohet që palët e interesuara të ndikojnë në zhvillimin e politikave që i prekin ata. Nga ana tjetër, përmes pjesëmarrjes së palëve të interesuara në këto procese, krijuesit e politikave fitojnë ide të reja, informata dhe qasje në burime të rëndësishme në procesin e krijimit të politikave. Në fund, konsultimet kontribuojnë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe zhvillimin e parimeve demokratike. Konsultimet kryhen në tre mënyra, përkatësisht: (1) nëpërmjet shpalljes së fillimit të procesit që është hapi i parë në konsultim, ku publiku është një aktor pasiv, por mundëson kohë përgatitjeje për palët e interesuara; (2) përmes konsultimeve që përfshijnë kërkimin aktiv të opinionëve dhe pikëpamjeve nga ata që janë të prekur. Ky është, në thelb, një proces i mbledhjes së informacionit, por edhe i dialogut të vazhdueshëm; dhe (3) përmes pjesëmarrjes aktive (pjesëmarrjes), gjegjësisht përfshirjes së palëve të interesuara në procesin e hartimit të politikave.

Zhvillimi i shoqërisë civile ka rëndësi të jashtëzakonshme për vlerat demokratike të një vendi dhe për nxitjen e vetëdijes qytetare, thuhet në “Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile 2022- 2024”. Vizioni i Strategjisë është përmirësimi i mjedisit në të cilin funksionon dhe zhvillohet shoqëria civile, gjë që kontribuon në forcimin e qeverisjes demokratike dhe vendosjen e një dialogu strukturor me shoqërinë civile. Në vitet e fundit, në Maqedoninë e Veriut janë krijuar disa mekanizma konsultativë, me përfaqësues të shoqërisë civile që kontribuojnë në procese konsultative më dinamike, siç është Këshilli Koordinues dhe Monitorues i Partneritetit për Qeverisje të Hapur⁵⁵, Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile⁵⁶, grupet sektoriale të punës⁵⁷, Këshilli Kombëtar për Reformat në Sferën Mediatike, Këshilli për Reformat në Drejtësi etj. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përfshirë shoqërinë civile në krijimin e politikave dhe politikave strukturore në një mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe transparente⁵⁸.

Për sa i përket akteve juridike⁵⁹, ka disa që ofrojnë bazën për përfshirjen e publikut në proceset e krijimit të politikave, gjegjësisht e rregullojnë këtë çështje, si p.sh. Rregullorja e Punës së Qeverisë së RMV-së, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile⁶⁰, Kodi i Praktikave të Mira për Pjesëmarrjen e Sektorit Civil në Procesin e Krijimit të Politikave, Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, Udhëzimet për Mënyrën e Veprimit në Punën e Ministrive në Procesin e Zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, Rregullorja për Organizimin e Konsultimeve Publike me rastin e fillimit të procesit legjislativ etj. Regjistër i Vetëm Kombëtar i Dispozitave (ENER) është kanali përmes të cilit zhvillohen konsultimet elektronike për propozimet e politikave.

Për shkak të ekzistencës së një platforme qendrore, siç është ENER-i, Qeveria dhe të gjitha ministrinë janë vlerësuar pozitivisht për ofrimin e mundësisë për të kryer konsultime online. Megjithatë, në faqet e internetit të ministrive, përveç Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, nuk ka një seksion të veçantë me informacionin e nevojshëm për shpalljen e proceseve të krijimit të politikave me lidhje direkte deri te ENER-i. Njësoj sikurse edhe vitin e kaluar, vetëm në gjashtë ministri regjistruam thirrje për debate

55 I krijuar për të futur një qasje më të strukturuar ndaj proceseve të PQH-së duke maksimizuar pjesëmarrjen dhe angazhimin, si dhe duke monitoruar dhe drejtuar zbatimin e planeve të veprimit të PQH. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/LKKGXcO>.

56 Është themeluar si organ këshillëdhënës i Qeverisë për avancimin e bashkëpunimit, dialogut dhe nxitjen e zhvillimit të shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=mk/node/99>.

57 Dialogu me BE-në. Grupet sektoriale të punës. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/iKKG06Y>.

58 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 i Komisionit Evropian. Komisioni Evropian. Shkarkuar nga: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

59 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për Referendum dhe Format e Tjera të Deklarimit të Drejtpërdrejtë, Ligji për Punën e Qeverisë së RMV-së, Ligji për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore dhe të tjera.

60 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile. Shkarkuar nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/Strategjia%20usvoena%2028%2012%202021.pdf>

publike në ueb-faqet e tyre (37,5%), por asnjëra nuk i publikon planet vjetore për debate publike. Raportet për konsultimet e kryera nuk publikohen në ueb-faqet e ministrive, por ato janë të integruara në raportet për vlerësimin e ndikimit rregullator. Vetëm Ministria e Mbrojtjes publikon në faqen e saj të internetit procesverbalet e debateve publike të zhvilluara me palët e interesuara⁶¹. Sipas udhëzimeve për zhvillimin e planeve strategjike dhe planeve vjetore të punës⁶², organet e administratës shtetërore pritet të sigurojnë planifikim dhe zbatim të koordinuar të politikave të Qeverisë. Megjithatë, konkluzioni i përgjithshëm është se sistemi elektronik për konsultime publike nuk është shfrytëzuar në potencialin e tij të plotë dhe nevojitet planifikimi dhe konsultimi i duhur për të kufizuar përdorimin e procedurave të shkurtuara për të mundësuar kontrollin dhe shqyrtimin efektiv të legjislacioni⁶³.

3.3.3 Efikasiteti (planifikimi strategjik, raportimi, monitorimi dhe vlerësimi)

Efikasiteti paraqet vlerësim të përkushtimit të institucioneve për të planifikuar edhe për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit – duke përdorur qëllime - tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit. Në dy nënkategori edhe atë: *raportimin dhe monitorimin dhe vlerësimin*, institucionet e pushtetit qendror u vlerësuan: nëse kanë dorëzuar me kohë raport për zbatimin e programit të punës; nëse kanë dorëzuar me kohë raportin financiar vjetor për vitin aktual; a përdorin tregues të performancës kur formulojnë programin vjetor, gjegjësisht për raportin vjetor të veprimtarisë për vitin e kaluar. Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë është vlerësuar për ekzistimin e mekanizmeve dhe për gjithëpërfshirjen e kornizës ligjore për planifikimin strategjik, krijimin dhe koordinimin e politikave. Duhet pasur parasysh se ndërveprimi me publikun dhe përfshirja e palëve të interesuara në proceset e krijimit të politikave, si dhe vlerësimi i ndikimit rregullator, si parime të qeverisjes së mirë, e të cilat u vlerësuan në kategorinë e *qasshmërisë*, ndikojnë në performancën e institucioneve.

Procesi i planifikimit strategjik është një mjet përmes të cilit përcaktohen strategjitë dhe politikat dhe merren vendime për prioritetet dhe qëllimet kryesore, si dhe për shpërndarjen e burimeve. Prandaj thuhet se planifikimi strategjik paraqet një nga hapat bazë drejt përmbushjes së misionit, gjegjësisht kompetencave të një institucioni. Monitorimi i zbatimit të politikave, si dhe konsultimet proaktive publike janë pjesë e së njëjtës sekuencë të zhvillimit të politikave të përgjegjshme të bazuara në dëshmi. **Në këtë nënkategori vëmendje e veçantë i kushtohet disponueshmërisë së mekanizmeve sistematike që e vlerësojnë rregullisht ndikimin, kostot dhe efektet e politikave dhe si të tilla shërbejnë për zhvillimin e planeve strategjike për të ardhmen, duke u mbështetur në të dhënat si dëshmi..**

Korniza ligjore për planifikimin strategjik, krijimin dhe koordinimin e politikave⁶⁴ është përcaktuar dhe përfshin rregullativë ligjore dhe nënligjore të harmonizuar, përmes të cilës parashikohen mekanizma

61 Procesverbalet e debateve publike. Ministria e Mbrojtjes. Shkarkuar nga: <https://mod.gov.mk/javna-rasprava-za-zvmo>

62 Udhëzime për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 131/18).

63 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 i Komisionit Evropian. Komisioni Evropian. Shkarkuar nga: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>.


64 Ligji për Qeverinë, Ligji për Buxhetet, Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Metodologjia për Analizë dhe Koordinim të Politikave (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 56/06), Metodologjia për Planifikimin Strategjik dhe Përgatitjen e Programit Vjetor për Punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 124/08 dhe 58/18), Udhëzime për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 131/18), Udhëzime për përgatitjen e planeve strategjike të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, Udhëzues për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit për zbatimin e planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 130/18), Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 107/13 dhe 173/17), Metodologjia për Vlerësimin e Zbatimit të Rregullativës (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 2013), Udhëzues për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit rregullator (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/13), Vendimi për formën dhe përmbajtjen e Raportit për vlerësimin e ndikimit rregullator (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/13), Kodi i praktikave të mira për pjesëmarrjen e sektorit civil në procesin e krijimit të politikave (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 99/11, Rregullorja për organizimin e konsultimeve publike me rastin e fillimit të procesit legjislativ.

dhe procedura efikase për zbatimin dhe monitorimin e procesit me kompetencë të përcaktuar në mënyrë adekuate. Ministritë përgatisin plane strategjike afatmesme (trevjeçare) që duhet t'i përmbajnë politikat e planifikuara që janë në kompetencë të tyre dhe mbi bazën e të cilave duhet të planifikohet buxheti në fushën përkatëse. Megjithatë, ky proces kryhet formalisht, ndërkohë që nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme ndërlidhjes së prioriteteve qeveritare dhe sektoriale, aktiviteteve të planifikuara dhe të ndërmarra për periudhën e ardhshme me shpërndarjen e duhur të fondeve të nevojshme, kështu që me Strategjinë e re për Reformën e Administratës Publike (2023 – 2030), parashikohen synime të përgjithshme dhe të veçanta dhe masa që e pasqyrojnë qasjen sektoriale në krijimin e politikave, planifikimin e fondeve, forcimin e kapaciteteve administrative dhe përkushtimin për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian.

Planifikimi strategjik u ndihmon ministrive dhe organeve ekzekutive që të planifikojnë në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme programet, projektet dhe aktivitetet e parashikuara në Programin Kombëtar për miratimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian⁶⁵ (NPAA), për të monitoruar zbatimin e tyre dhe për t'iu përshtatur çdo ndryshimi. Në fakt, në planet strategjike të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore duhet të shtjellohen me hollësi masat dhe aktivitetet e parashikuara në NPAA, gjegjësisht të sigurohet përputhshmëria e dy akteve⁶⁶.

Sekretariati i Përgjithshëm ndjek një kornizë për monitorim dhe vlerësim, sipas të cilës ata e planifikojnë dhe e raportojnë punën e tyre në baza vjetore. Plani strategjik i Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së për periudhën 2022-2024 është harmonizuar me Buxhetin e RMV-së.⁶⁷ Mirëpo, deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë nuk ka publikuar Raport për Zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2022.⁶⁸

EFIKASITETI – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



65 Bazat e të dhënave. Sekretariati për Çështje Evropiane. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/RKKH4QL>.

66 Doracak për Planifikim Strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/LKKHC6r>.

67 planifikimi strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/PKKJffN>.

68 Shih: <https://vlada.mk/strateshko-planiranje> Qasja e fundit më 28.9.2023.

Përmes treguesve të efikasitetit, pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministrinë dhe organet ekzekutive) është vlerësuar me 52,82% përmbushje të treguesve. Shikuar individualisht, organet ekzekutive edhe në këtë kategori anë në fund të shkallës për sa i përket përmbushjes së treguesve të efikasitetit me 38,42%, më lartë janë ministrinë me 53,43% përmbushje të treguesve dhe në vend më të lartë është qeveria me 66,6% përmbushje të treguesve të efikasitetit.

Sa i përket përdorimit të treguesve të suksesit gjatë planifikimit, 62,5% e ministrive raportojnë se i zbatojnë ato, ndërsa gjysma e tyre (56,25%) përdorin edhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre. Rezultati është pothuajse identik në mesin e organeve ekzekutive, gjegjësisht 68,42% e organeve ekzekutive raportojnë se përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit, por vetëm 26,31% e tyre përdorin tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.

Nga ministrinë, 62,5% kanë dorëzuar me kohë raport për zbatimin e programit për punë të qeverisë, e pak më pak, 56,25% prej tyre kanë dorëzuar me kohë raport vjetor financiar për vitin aktual. Përmbushja nga organet ekzekutive është më e dobët, gjegjësisht 36,84% kanë dorëzuar me kohë raport vjetor, e po aq kanë dorëzuar edhe raport vjetor financiar për vitin aktual.

Mbetet i nevojshëm forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore për koordinimin e procesit të planifikimit afatmesëm dhe për lidhjen e tij me strategjitë sektoriale, buxhetimin dhe planifikimin vjetor. Në fund, roli i Sekretariatit të Përgjithshëm si organ qendror për koordinimin dhe kontrollin e cilësisë mbetet i pamjaftueshëm⁶⁹.

3.3.4. Integriteti

Korrupsioni është një nga problemet më gërryese të ditëve të sotme. Korrupsioni çon në politika të gabuara publike, i shpërdoron burimet publike në mënyrë të panevojshme, zgjeron pabarazitë ekonomike dhe sociale, krijon pakënaqësi dhe polarizim politik dhe e ul besimin në institucionet që duhet t'i shërbejnë interesit publik.

Qasjet tradicionale, të bazuara në krijimin e sa më shumë rregullave, respektimin më të rreptë të legjislacionit dhe zbatimin më të rreptë, padyshim kanë efikasitet të kufizuar. Shumë autorë që e hulumtojnë këtë temë konstatojnë se përgjigja strategjike dhe e qëndrueshme ndaj korrupsionit duhet të jetë integriteti publik⁷⁰.

Integriteti përfaqëson një kryqëzim të vlerave individuale dhe institucionale dhe si i tillë është i vështirë për t'u përcaktuar dhe kontrolluar. Por në thelb, integriteti nënkupton kryerjen ligjore, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të punës me të cilën zyrtarët e mbrojnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit në të cilin janë ose person përgjegjës ose të punësuar, i eliminonë rreziqet dhe i largojnë dyshimet për mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe në këtë mënyrë sigurojnë besimin e qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike⁷¹. Nga këndvështrimi i sotëm, shteti ka shfaqur një tendencë përmirësimi të pozicionit të tij në luftën kundër korrupsionit për dy vite radhazi⁷², por mbetet e rëndësishme krijimi dhe imponimi i një vizioni për një strategji të integritetit publik, duke e hequr fokusin nga politikat ad-hoc të integritetit, nëpërmjet një përqasjeje që bazohet në kulturën e integritetit. Sepse, përfundimi është se në vitin 2022 korrupsioni

69 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 i Komisionit Evropian. Komisioni Evropian. Shkarkuar nga: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>.


70 Termat dhe kushtet, OECD. Shkarkuar nga: <https://www.oecd.org/termsandconditions/>.

71 Politika për integritet e organeve shtetërore. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/JKKFc86>.

72 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021 dhe 2022, "Transparency International". Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/hKKJVPD> и <https://transparency.mk/?s=%D0%98%D0%BD%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81+%D0%BD%D0%B0+%D0%BF%D0%B5%D1%80%D1%86%D0%B5%D0%BF%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0+%D0%BD%D0%B0+%D0%BA%D0%BE%D1%80%D1%83%D0%BF%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0+%28%D0%98%D0%9F%D0%9A%29+%D0%B7%D0%B0+2022>.

mbetet i përhapur në shumë fusha dhe është një çështje shqetësuese⁷³. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të krijohen mekanizma që do të parandalojnë rastet e ekspozimit ndaj ryshfetit (mitës) dhe përdorimit të lidhjeve personale, e deri te praktikata e përhapura të nepotizmit, miqësisë, klientelizmit, d.t.th abuzimit të ndikimit politik që ndodh midis elitave⁷⁴. Pjesë e këtyre mekanizmave janë politikat e integritetit, kodet etike, rregullat e mbrojtjes së sinjalizuesve, mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit, rregullimi i lobimit etj. Pra, në këtë nënkategori, ato shihen si mënyra përmes të cilave mund të parandalohehet dhe të kontrollohet shfaqja e ndikimit politik, gjegjësisht keqpërdorimi i pushtetit.

INTEGRITETI – % e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Nëpërmjet treguesve për integritet, pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) është vlerësuar me 59,02% përmbushje të treguesve. Shikuar individualisht, organet ekzekutive edhe në këtë kategori janë në fund të shkallës për sa i përket, përmbushjes së treguesve për integritet me 42,1%, më lartë është Qeveria me 64,71% përmbushje të treguesve, ndërsa në vend më të lartë janë ministritë me 70,25% përmbushje të treguesve për integritet.

Qeveria u vlerësua për ekzistencën dhe disponueshmërinë e politikave që ndikojnë në parandalimin e korrupsionit, ndërtimin e sistemit për integritet, rregullat për publikimin e fletëve anketuese nga funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar për të dorëzuar të dhëna për gjendjen e tyre të pasurisë⁷⁵ dhe rregullat për mbrojtjen e sinjalizuesve. Krahasuar me vitin e kaluar (84,6%), Qeveria ka një rënie në përmbushjen e pikëve të indeksit në këtë nënkategori me 64,71%. Kodi për nëpunësit administrativë dhe Kodi i sjelljes etike për anëtarët e qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria janë publikuar në faqen e internetit të Qeverisë⁷⁶, dhe është krijuar një seksion i veçantë me informacione për mbrojtjen e

73 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 i Komisionit Evropian. Komisioni Evropian. Fq. 19. Shkarkuar nga: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>.

74 Angazhimet kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut: strategjitet për ndërtimin e angazhimit konstruktiv. Fondacioni "Shoqëri e Hapur" i Maqedonisë. Viti 2020. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/6KKKjBW>.

75 Të dhënat nga fletët anketuese mbi gjendjen e pasurisë së funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: https://www.dksk.org.mk/imoti_2/.

76 Kodi. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/kodeks>.

sinjalizuesve⁷⁷. Gjithashtu, qeveria është vlerësuar pozitivisht për faktin që ka miratuar një politikë për integritet, e cila është gjithashtu e disponueshme për publikun⁷⁸. Megjithatë, ka marrë pikë negative për shkak të mos publikimit të Raportit vjetor për zbatimin e politikës së integritetit dhe për shkak të mungesës së aktiviteteve edukative për nëpunësit për tema si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Mund të konkludohet se nevojitet zbatim më i fortë⁷⁹ i politikave për të dhënë një vlerësim të efikasitetit të tyre, e që do të ndjehet nga qytetarët për të cilët korrupsioni është problemi më i madh.⁸⁰

Sa i përket arritjeve të ministrive, të gjitha kanë informacion për mbrojtjen e sinjalizuesve në faqet e internetit, përveç Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, ndërsa 7 raportojnë se nëpunësit kanë marrë pjesë në aktivitete edukative për tema siç është parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesave dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjatë vitit 2022. Këtë vit, 87.5% e ministrive kanë publikuar politikë për integritet në faqet e internetit, gjegjësisht këtë nuk e kanë bërë vetëm Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive. Tek organet ekzekutive, përmbushja e treguesve të kësaj nënkategorie është dukshëm më e dobët, me një përmbushje prej 41,1% të treguesve. Në fakt, 84,2% e organeve ekzekutive kanë informacion në faqet e tyre të internetit për mbrojtjen e sinjalizuesve, por vetëm dy institucione (10,5%) kanë raportuar se nëpunësit kanë marrë pjesë në aktivitete edukative për tema siç është parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesave dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjatë vitit 2022. 68,42% e organeve ekzekutive raportojnë se kanë politika të brendshme të integritetit. Këto të dhëna tregojnë se, përveç se ekziston korniza ligjore, është e nevojshme të punohet për zbatimin e përforcuar të saj. Zhvillimi i një shërbimi publik dhe profesional të bazuar në merita do të rrisë llogaridhënien dhe do të parandalojë politizimin, dhe rrjedhimisht, do ta ulë ndjeshëm rrezikun e konfliktit të interesave dhe korrupsionit.

Përçindja e përmbushjes së treguesit midis ministrive (6,25 %) dhe organeve ekzekutive (5 %) është shumë e ulët për sa i përket përgatitjes dhe publikimit të raporteve për zbatimin e politikave për integritet dhe/ose çdo politikë tjetër të brendshme antikorrupsion që parashikon masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljeve korruptive dhe joetike në institucion. Nga ministrinë, vetëm Ministria e Mbrojtjes⁸¹ ka publikuar një raport për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022, ndërsa nga organet ekzekutive që janë monitoruar, Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në aspektin e lobimit, si pjesë e kornizës me të cilën është rregulluar, në vitin e monitoruar ka progres të pjesshëm, duke qenë se është miratuar Ligji i ri për Lobim, dhe KSHPK-ja⁸² miratoi akte të brendshme për përgatitjen e hyrjes në fuqi të ligjit në qershor të vitit 2022, me qëllim të parandalimit të ndikimit të paligjshëm në politikat dhe proceset publike dhe efektet e mundshme korruptive.

77 Mbrojtja e sinjalizuesve. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/ukazuvaci>.

78 Politika për integritet e Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/OKKK6WK>.

79 GRECO 2021, Raporti i Pajtueshmërisë së Maqedonisë së Veriut, Rrethi i pestë i vlerësimit – Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksionet e larta ekzekutive dhe zbatimin e ligjit). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/JKKLvwe>.

80 Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Viti 2021. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/pKKLEZe>.

81 Dokumentet strategjike. Ministria e Mbrojtjes. Shkarkuar nga: <https://mod.gov.mk/storage/2023/01/Plan-za-integritet-sestmesecen-izvestaj-Juli-Dekemvri-2022.pdf>


82 Lobimi. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/xKKZlnb>.

3.3.5. Të dhënat e hapura

Të dhënat e hapura në këtë hulumtim vëzhgohen si një shtyllë e përbashkët e qeverisjes së mirë duke vlerësuar shkallën e hapjes së të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të shqyrtuara përmes Indeksit të Hapjes. Indeksi rajonal tregon rezultatet më të mira për Maqedoninë e Veriut, megjithëse ka një përmbushje modeste prej 38,81% të treguesve (individualisht Qeveria përmbush 46,36%, organet ekzekutive përmbushin 41,01%, ndërsa ministritë përmbushin 35,09% të treguesve të të dhënave të hapura).

Në nivel të politikave, mund të thuhet se është arritur një marrëveshje ndërmjet aktorëve politikë për

Të dhënat e hapura – rezultatet me % të përmbushjes së indikatorëve në vendet e Ballkanit Perëndimor



rëndësinë e e-qeverisjes, dhe kjo reflektohet në aktivitetet e shumta të ndërmarra në këtë drejtim⁸³. Si pjesë e të ashtuquajturës “Agjenda Digjitale për Evropën”, Maqedonia e Veriut vazhdoi të zbatojë prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Bandë të Gjerë, 2019-2023, dhe në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, 2018-2022.⁸⁴ Administrata moderne dhe efikase publike, e bazuar në digjitalizim, e cila ofron shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët dhe bizneset, është pjesë e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pjesë e Programit të Qeverisë për vitin 2022, i cili përfshin disa projekte, si dhe iniciimin e zgjidhjeve përkatëse ligjore. Nevoja për digjitalizim njihet edhe në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike (2023 – 2030)⁸⁵ dhe Planin e Veprimit, ndërsa masat dhe aktivitetet e pazbatuara nga Strategjia e të Dhënave të Hapura, 2018-2020⁸⁶ janë të përfshira në Draft

83 Maqedonia e Veriut “Observatori i Agjendës Digjitale”, qershor 2022. Fondacioni Metamorfozis, në dispozicion në https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/opservatorija-za-digitalnata-agenda-izveshtaj-za-tekovnata-sostojba-i-patokaz-za-unapreduvanje-na-digitalnata-agenda-vo-severna-makedonija-2022/

84 Raporti për Maqedoninë e Veriut. Tetor, 2021 Komisioni Evropian. Në dispozicion në <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

85 Strategjia për Reformën e Administratës Publike (2023– 2030). Në dispozicion në https://ener.gov.mk/PublicDocuments/Haupt%20текст%20на%20стратегията%20за%20РЈА%202023-2030_Haupt_id=47_version=1.pdf


86 Strategjia e të Dhënave të Hapura (2018 - 2020) dhe Plani i Veprimit. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/iKKZPYr>.

Strategjinë e Qeverisë për Transparencë (2023-2026) dhe në Planin e Veprimit⁸⁷. Në Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2021 – 2023) në të gjitha angazhimet ka ndërthurje të masave për rritjen e grupeve të të dhënave në format të hapur.

Shumica e institucioneve (83%) raportojnë se nuk kanë staf të trajnuar për përdorimin dhe publikimin e të dhënave të hapura, dhe është evidente se shoqëria civile luan një rol kyç në zhvillimin e kapaciteteve të sektorit publik në këtë fushë. Gjatë vitit 2022, “Metamorfozis” zhvilloi trajnime për të dhënat e hapura për përfaqësues të ministrive dhe të organeve përbërëse.

Nga gjithsej 36 institucione që e përbëjnë mostrën e institucioneve që janë monitoruar nga hulumtimi ynë, vetëm pesë ministri (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit me Ujërat dhe Ministria e Drejtësisë) dhe një organ ekzekutiv (Byroja e Sigurisë Publike) raportuan se nëpunëst nga institucionet e tyre kishin aktivitete edukative/punëtori/trajnime mbi të dhënat e hapura në vitin 2022.

Të dhëna të hapura – veçmas sipas grupeve të institucioneve



Gjithashtu, Metamorfozis i trajnon vazhdimisht institucionet për t'i hapur grupet e tyre të të dhënave. Në vazhdim të bashkëpunimit me institucionet shtetërore, në vitin 2022 u ofrua mbështetje mentorale për 4 institucione në procesin e katalogimit dhe publikimit të grupeve të të dhënave të tyre. Të katër institucionet (Agjencia e Punësimit, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Fondi i Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor) miratuan procedura për dhënat e hapura, bënë katalogimin dhe priorizimin e grupeve të të dhënave nga katalogu. Gjithashtu, në vitin 2022, “Metamorfozis” organizoi edhe konferencën e parë ndërkombëtare të të dhënave të hapura në Ballkan, ku morën pjesë shumë ekspertë dhe praktikues nga vendi, rajoni dhe Evropa.

87 Draft strategjia për Transparencë e Qeverisë (2023 – 2026). Në dispozicion në <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocument&etails&detalisId=64>

Lista e renditjes së institucioneve me shkallë të përbushjes së treguesve të të dhënave të hapura

Qeveria dhe ministrinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut		% e përbushjes së treguesve të të dhënave të hapura
1.	Ministria e Mbrojtjes	58.03%
2.	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	46.36%
3.	Ministria e Financave	42.9%
4.	Ministria e Punëve të Brendshme	40.7%
Nën mesataren prej 40,67% të Qeverisë dhe të ministrive		
5.	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	39.6%
6.	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	38.5%
7.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	37.4%
8.	Ministria e Shëndetësisë	37.4%
9.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	37.4%
10.	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	36.81 %
11.	Ministria e Kulturës	34.1%
12.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave	31.9%
13.	Ministria e Punëve të Jashtme	30.8%
14.	Ministria e Ekonomisë	27.5%
15.	Ministria e Drejtësisë	26.4%
16.	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	23.1%
17.	Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	19.04%

Organet ekzekutive		% e përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura
1.	Byroja e Zhvillimit Rajonal	52.8%
2.	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor	50.16%
3.	Byroja për Siguri Publike	47.52%
4.	Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit	47.52%
5.	Inspektorati Shtetëror i Tregut	47.52%
6.	Inspektorati Shtetëror i Arsimit	44.88%
7.	Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	44.88%
8.	Inspektorati Shtetëror i Pyltarisë dhe Gjuetisë	44%
9.	Enti Shtetëror i Statistikave	42.24%
Nën mesataren prej 41,29% të organeve ekzekutive		
11.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor	39.6%
12.	Byroja për Furnizime Publike	39.6%
13.	Byroja për Ekspertizë Ligjore	39.6%
14.	Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	39.6%
15.	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve	39.6%
16.	Agjencia e Emigracionit e Republikës së Maqedonisë së Veriut	34.32%
17.	Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik	34.32%
18.	Drejtoria e të Ardhurave Publike	34.32%
19.	Drejtoria e Policisë Financiare	30.36%
20.	Sekretariati për Çështje Evropiane	26.4%

4. REKOMANDIME PËR PUSHTETIN EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

TRANSPARENCA

- Të gjitha organet ekzekutive duhet të kenë një seksion i veçantë në faqen e internetit për të mundësuar transparencë aktive dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë me publikun dhe llogaridhënie. Të aktivizohen kërkuesit funksional në të gjitha faqet e internetit të organeve ekzekutive.
- Institucionet duhet të fusin procedura të brendshme që do ta avancojnë procesin e transparencës reaktive, por edhe atë aktive, me afate të përcaktuara dhe persona përgjegjës për shpërndarjen dhe përditësimin e informacioneve në faqet e tyre të internetit.
- Institucionet duhet detyrimisht t'i publikojnë programet vjetore të punës dhe rregullisht të publikojnë raporte për punën e tyre. Të shpreshtohet përgatitja dhe publikimi i raporteve tremujore ose gjashtëmujore.
- Qeveria duhet t'i publikojë dokumentet që shqyrtohen dhe që diskutohen gjatë seancave, si dhe transkriptet e mbledhjeve. Nga ana tjetër, transmetimi audio dhe/ose video i seancave që do t'i jepte qasje të drejtpërdrejtë publikut për të ndjekur vendimmarrjen për politikën që i prekin drejtpërdrejt, do të ishte një praktikë e mirë shtesë për t'u marrë në konsideratë.
- Qeveria duhet të kryejë konsultime me publikun gjatë planifikimit të buxhetit, si dhe të publikojë informacion në faqen e saj të internetit për shpenzimin e rezervave buxhetore.
- Qeveria duhet të dorëzojë në Kuvend Propozim-ligjin e buxhetit të paktën tre muaj para përfundimit të vitit fiskal për të siguruar kohë të mjaftueshme për shqyrtim efektiv.
- Institucionet duhet të publikojnë rregullisht planet e tyre buxhetore dhe raportet financiare vjetore dhe gjashtëmujore.
- Të rregullohet mundësia që nëpunësit që kryejnë furnizime publike të jenë të detyruar të plotësojnë një deklaratë të konfliktit të interesit dhe të dorëzojnë fletë anketuese për gjendjen e pasurisë.
- Të publikohen pronarët të vërtetë të ofertuesve dhe të kompanive që paraqiten në thirrjet për furnizime publike dhe të atyre që kanë lidhur marrëveshje me institucionet në procedurën e furnizimit publik. Të krijohet një regjistër i pronarëve të vërtetë.
- Institucionet t'i lidhin të dhënat në lidhje me furnizimet publike (me link), të cilat ndodhen në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike, me faqet e tyre të internetit.
- Institucionet të marrin masa konkrete në standardizimin e furnizimeve publike.

QASSHMËRIA


- Institucionet duhet t'i publikojnë në faqen e tyre të internetit përgjigjet me të cilat kanë mundësuar qasje në informata pas një kërkesë të parashtruar (nga qasja reaktive në atë aktive), gjë që do ta reduktonte përsëritjen e kërkesave të marra me shkrim për të njëjtat informata.
- Është e nevojshme që institucionet ta publikojnë në mënyrë proaktive paketën e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat, me Karakter Publik, gjë që do të ndikojë në rritjen e transparencës aktive. Të zbatohet Udhëzimi për përmirësimin e transparencës së institucioneve në sektorin publik.
- Të zvogëlohet afati maksimal për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik nga 20 në 15 ditë, duke qenë se kjo është një periudhë e arsyeshme pritjeje sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikës së vendosur rajonale.
- Organet ekzekutive duhet të vendosin një hapësirë (seksion) të veçantë në faqet e internetit dedikuar procedurës me kërkesat për qasje të lirë në informata.
- Nëpunësit duhet të trajnohen rregullisht për standardet ndërkombëtare dhe vendore për përmirësimin e qasjes në informacion, gjë që do të ndikojë edhe në rritjen e shkallës së përgjigjeve dhe cilësinë e përgjigjeve ndaj kërkesave.
- Institucionet duhet të krijojnë kanale të drejtpërdrejta në faqet e internetit për komunikim online, për të mundësuar ndërveprim më të lehtë me qytetarët. Kanalet duhet të ofrojnë mundësi për qytetarët që të parashtrojnë ankesa ose propozime.
- Faqet e internetit duhet të ofrojnë udhëzime të qarta dhe t'i promovojnë mekanizmat e disponueshëm për parashtrim të ankesave.
- Institucionet, paralelisht me avancimin e faqeve të internetit, duhet ta përmirësojnë prezencën e tyre në mediat sociale duke publikuar rregullisht informacione shërbimi për publikun dhe t'i orientojnë ata për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat, proceset dhe mekanizmat që nuk janë aq të njohur në publikun e gjerë.
- Institucionet, veçanërisht organet ekzekutive, duhet të publikojnë listat e shërbimeve që i ofrojnë në faqen e internetit, si dhe në një vend të dukshëm të vendosin një lidhje deri te portali www.uslugi.gov.mk. Gjithashtu, institucionet duhet të rrisin promovimin e portalit www.uslugi.gov.mk në mediat sociale.
- Proceset e krijimit të politikave duhet të planifikohen paraprakisht dhe për këtë arsye duhet të jenë të parashikueshme, gjegjësisht planet vjetore për konsultimin e palëve të interesuara duhet të publikohen në faqet e internetit. Përveç kësaj, këto plane duhet të shpërndahen tek palët e interesuara në kohën e duhur, si dhe të promovohen në mënyrë që publiku të mund ta dijë afatin kohor, të planifikojë dhe të përgatitet për proceset e ardhshme të krijimit të politikave. Komunikimi në kohë dhe efektiv me publikun në lidhje me proceset e konsultimeve publike është i një rëndësie të madhe për marrjen e kontributit thelbësor nga palët e interesuara.
- Institucionet duhet të vendosin në faqet e tyre të internetit një seksion të veçantë me informacionin e nevojshëm për shpalljen e proceseve të krijimit të politikave me një lidhje direkte deri te ENER-i.
- Është e nevojshme vendosja e kontrollit të cilësisë së konsultimeve publike. Për të siguruar besim në procesin e konsultimit dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen, institucionet duhet të japin informata kthyesë nga konsultimet, gjegjësisht të krijojnë procesverbale nga proceset e konsultimit, si një aktivitet vijues me arsyet pse disa propozime nuk janë pranuar.

EFIKASITETI

- Institucionet të përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit dhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.
- Duhet të zbatohet roli i Sekretariatit të Përgjithshëm për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të politikave ekzistuese.
- Qeveria duhet ta zvogëlojë trendin e numrit të propozim-ligjeve që propozohen me procedure të shkurtuar, veçanërisht para periudhës zgjedhore, në mënyrë që të mos rrezikohet cilësia e tyre dhe/ose të ulet pjesëmarrja e palëve të interesuara në konsultime.
- Qeveria duhet t'i shmanget ndryshimit të politikave pa dëshmi se ndryshimet e propozuara do të ofrojnë përmirësime të konsiderueshme. Kërkohet angazhim dhe krijimi i praktikës për kryerjen e analizave ex ante dhe ex post.
- Të gjitha institucionet duhet ta përmirësojnë përdorimin konsekuent të të dhënave për qëllime administrative dhe ta bazojnë planifikimin dhe raportimin e tyre mbi to.

INTEGRITETI

- Institucionet të punojnë në mënyrë të përshejtuar në përgatitjen e politikave për integritet që pritet të publikohen në faqet e tyre të internetit, si dhe t'i përkushtohen përgatitjes dhe publikimit të raporteve për zbatimin e politikave për integritet.
- Institucionet duhet të rrisin ndjeshëm aktivitetet edukative për nëpunësit për tema si p.sh. konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve.
- Duhet të përmirësohet sistemi për monitorimin e gjendjes së pasurisë të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Përmirësimi i formatit në të cilin publikohen deklaratat e pasurisë në format të hapur. Forcimi i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për të mundësuar disponueshmërinë publike të deklaratave të pasurisë edhe pas përfundimit të kohës në të cilën kryhet funksioni.
- Ekziston nevoja për të forcuar instrumentet e monitorimit dhe raportimit në lidhje me kornizën ligjore dhe politike në këtë fushë, në mënyrë që të gjenerohen të dhëna për zbatimin e saj dhe të rritet besimi në sistem.



Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis

rr. "Apostol Guslarot" nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

e-mail: info@metamorphosis.org.mk

тел: +389 2 3109 325

www.metamorphosis.org.mk

